



EVALUIM I GJENDJES ME TË DREJTAT E NJERIUT DHE SUNDIMIN E SË DREJTËS GJATË KRYESIMIT TË OSBE-së

Prill, 2023

Titulli:

Evaluim i gjendjes me të drejtat e njeriut dhe sundimin e së drejtës gjatë kryesimit të OSBE-së

Botues:

Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut

Përfaqësuar nga:

Prof. Dr. Neda Zdraveva

Autore:

Vëzhgimi i zgjedhjeve - Simonida Kacarska

Mbrojtja e pakicave kombëtare - Ardit Abazi Imeri

Intoleranca - Hate speech - Slavica Anastasovska

Liria e shprehjes dhe bashkimit - Natasa Petkovska

Freedom of Expression and Association - Goce Kocevski

Trafikimi i qenieve njerëzore - Irena Zdravkova

Barazia gjinore - Bojana Jovanovska

Redaktore:

Natasa Boskova

Përkthimi në shqip:

Katerina Ivanisevikj

Viti i botimit:

2023

Place of issue:


Shkup

Numri i faqeve:

68

Dizajni grafik:

Masiva Creative Agency



Ky raport është përpiluar me mbështetje financiare të Komitetit holandez të Helsinkit, Fondacionit Shoqëri e Hapur – Maqedoni dhe Departamentit Federal Zviceran të Punëve të Jashtme. Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi e vetme e Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, Shoqatës Maqedonase të Juristëve të Rinj dhe Institutit për Politika Evropiane (EPI) – Shkup dhe nuk është e thënë që t'i reflektojë qëndrimet e Komitetit holandez të Helsinkit, Fondacionit Shoqëri e Hapur – Maqedoni dhe Departamentit Federal Zviceran të Punëve të Jashtme.

Përmbajtja

Kapitulli 1

VËZHGIMI I ZGJEDHJEVE5

Kapitulli 2

MBROJTJA E PAKICAVE KOMBËTARE9

Kapitulli 3

INTOLERANCA18

Kapitulli 4

LIRIA E SHPREHJES DHE BASHKIMIT.....36

Kapitulli 5

TRAFIKIMI I QENIEVE NJERËZORE51

Kapitulli 6

BARAZIA GJINORE57

Shkurtesat

KSHZ - Komisioni shtetëror i zgjedhjeve

OSBE - Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë

ODIHR - Zyra për institucionet demokratike dhe të drejtat e njeriut

MD - Ministria e Drejtësisë

IRI - Instituti Ndërkombëtar Republikan

KB - Kombet e Bashkuara

KE - Këshilli i Evropës

KE - Komisioni Evropian

SHBA - Shtetet e Bashkuara të Amerikës

KKKR - Komiteti Këshillimor për Konventën Kornizë për mbrojtjen e pakicave kombëtare

SLAPP - *Padi strategjike kundër veprimit publik*

LSHF - Ligji për shoqatat dhe fondacionet

VNRR - Vlerësimi i ndikimit të rregullativës

MSHIA - Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës

TQNJ - Trafikimi i qenieve njerëzore

PSO - Procedurat standarde operative

MKR - Mekanizmi Kombëtar i Referimit për Viktimat e Trafikimit të Qenieve Njerëzore

PTHPNKOK - Prokuroria Themelore Publike për Ndjekjen e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit

GRETA - Grupi i Ekspertëve të Këshillit të Evropës për Veprimin kundër trafikimit të qenieve njerëzore

ONP - Organizata Ndërkombëtare e Punës

VT - Viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore,

CEDAV - Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave

LPMD - Ligji për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi

Kapitulli 1 – VËZHGIMI I ZGJEDHJEVE

1.1. Sistemi zgjedhor i Maqedonisë së Veriut

Maqedonia e Veriut është demokraci parlamentare shumëpartiake. Për momentin, ka 57 parti të regjistruara politike.¹ Duke marrë parasysh karakterin shumetnik të vendit, partitë politike shpesh organizohen rreth interesave të grupeve të caktuara etnike. Partitë politike mund të garojnë në zgjedhjet parlamentare për deputetë, në zgjedhjet lokale për kryetarë komunash dhe anëtarë të këshillave komunalë dhe në zgjedhjet presidenciale.

Korniza legislative, gjithashtu, lejon që kandidatët e pavarur të garojnë në zgjedhje. Parashtrimi i kandidaturës paraprihet nga mbledhja e një numri të caktuar të nënshkrimeve (siç përcaktohet në Kodin Zgjedhor), ose nga votuesit ose nga deputetët, në varësi nga ajo se kush e parashtron kandidaturën në emër të kandidat-it/ëve të pavarur. Nënshkrimet mblidhen në njësitë rajonale të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve (KSHZ), ndërsa procedura është e përcaktuar me Rregulloren që e miraton KSHZ-ja.

Zgjedhjet presidenciale mbahen çdo pesë vjet, ndërsa zgjedhjet lokale dhe parlamentare mbahen çdo katër vjet. Por, për shkak të pasigurisë politike dhe krizave të shpeshta politike, e ndonjëherë edhe për shkak të përplasjeve politike, në vitin 2020 në vend u mbajtën zgjedhjet e pesta të parakohshme parlamentare.

Që nga viti 2002, sistemi zgjedhor parlamentar në Maqedoninë e Veriut ka qenë proporcional, me² lista të mbyllura të kandidatëve. Kuvendi përbëhet prej 120 deputetëve të zgjedhur në gjashtë njësi zgjedhore, ndërsa rezultatet përlogariten sipas **formulës D'Hondt**. Deri në tre deputetë plotësues zgjidhen përmes votimit jashtë shtetit³ në një njësi zgjedhore.⁴ Nga votimi brenda shtetit, zgjidhen 20 deputetë nga secila prej gjashtë njësitë zgjedhore. Detaje plotësuese për njësitë zgjedhore, votimin jashtë shtetit, llojet e listave dhe Listën e zgjedhësve janë dhënë në kapitujt e radhës.

Përveç numrit të madh të partive aktive politike, shumica e partive të vogla konkurrojnë në zgjedhje në koalicione parazgjedhore, të kryesuar zakonisht prej njëres nga dy partitë më të mëdha politike - Lidhja Socialdemokratike e Maqedonisë (e njohur si LSDM) ose Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase - Partia Demokratike për Unitetin Kombëtar Maqedonas (e njohur si VMRO-DPMNE), në mënyrë që t'i rrisin shanset për t'u përfaqësuar në Kuvendin.

Maqedonia e Veriut është demokraci konsociale, e cila, ndër elementët e tjerë kryesorë, karakterizohet me qeveri të mëdha të koalicionit që përfaqësojnë grupe të ndryshme etnike. Në praktikë, koalicionet paszgjedhore formohen midis njëres prej dy partive më të mëdha maqedonase, e cila zakonisht fiton numrin më të madh të përgjithshëm të vendeve dhe një (ose më shumë) partive fituese shqiptare. Kjo praktikë bazohet kryesisht në Marrëveshjen joformale të majit, e cila parashikon që partitë fituese nga të dy grupet etnike të formojnë një qeveri.⁵ Mirëpo, kjo praktikë joformale është ndërprerë në zgjedhjet e parakohshme parlamentare në vitin 2016, kur partia fituese shqiptare, Bashkimi Demokratik për Integritim (BDI), formoi Qeveri me socialdemokratët, të cilët morën më pak vota se VMRO-DPMNE-ja djathtiste. Një zhvillim interesant në formimin e koalicioneve ndodhi edhe në zgjedhjet e parakohshme parlamentare në vitin 2020, kur para zgjedhjeve u dakordua koalicioni i parë qeveritar parazgjedhor midis LSDM-së, një parti maqedonase dhe BESA, një nga partitë më të mëdha shqiptare.

¹Agjencia për mbrojtjen e të drejtës për qasje të lirë deri te Informacionet e karakterit publike. Lista e poseduesve të informacioneve/Partitë politike. E arritshme në: <https://aspi.mk/imateli/8/>

²Pankovski M., Jovevska-Gjorgjeviq A., Janeska S., Ilievaska M. dhe Mladenovska S. (v. 2020). *Doracak për zgjedhjet parlamentare në Republikën e Maqedonisë së Veriut viti 2020 (botimi i dytë i përditësuar)*. Fondacioni Konrad Adenauer, Instituti për Demokraci "Societas Civilis" - Shkup. Të gjitha ndryshimet në renditjen kronologjike mund të gjenden në pjesën e dytë: *Historia e zgjedhjeve parlamentare në Republikën e Maqedonisë së Veriut (1990 - 2016)*, duke përfshirë informacionet e detajuara për ndryshimet në vitin 2002. E arritshme në:

https://izbornaarhiva.mk/dokumentacija/prirachnici/Prirachnik_za_parlamentarni_izbori_2020_ENG.pdf

³Nga v. 2011

⁴Nga v. 2015

⁵Markoviq N. dhe Popoviq M. (v. 2015). *Dialogu politik*. Fondacioni Konrad-Adenauer. E arritshme në: https://idscs.org.mk/wp-content/uploads/2009/08/Politicki_dijalog.pdf

1.2. Gjetjet e organizatave ndërkombëtare

Zgjedhjet e fundit lokale u mbajtën në tetor të vitit 2021. Në shtator të vitit 2021, u miratuan disa ndryshime në Kodin zgjedhor në lidhje me këto zgjedhje pas një procedure të përshpejtuar dhe pa debat publik ose konsultim me palët kryesorë të prekura, në kundërshtim me praktikën e mirë ndërkombëtare.

Sipas Zyrës së Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, për institucione demokratike dhe të drejtat e njeriut (OSBE/ODIHR), këto ndryshime u referohen pjesërisht disa rekomandimeve paraprake të OSBE/ODIHR-it, siç është definimi i afatit të mandatit të anëtarëve të KSHZ-së. E kundërta e kësaj, rekomandimet tjera, duke përfshirë ato që kanë të bëjnë me një rishikim gjithëpërfshirës të kornizës juridike zgjedhore, mbetën të pazgjidhura.⁶

OSBE/ODIHR vlerësoi se zgjedhjet kanë qenë konkurrencte dhe se liritë themelore janë respektuar gjerësisht.⁷ Nga ana tjetër, raporti i Fridomhaus "Kombe në transit" për vitin 2022 tregoi se ndonëse zgjedhjet ishin në përgjithësi të lira dhe konkurrencte, kishte keqpërdorim të resurseve shtetërore nga partitë në pushtet, ndërsa fushatat zgjedhore u prishën nga retorika përçarëse dhe armiqësore.⁸

ODIHR theksoi rekomandimet parësore të tij, të tilla si krijimi i kushteve më të drejta për fushatat zgjedhore dhe reklamim politik, forcimi i kapaciteteve të organeve të udhëheqjes së zgjedhjeve dhe krijimi i mekanizmave plotësuese për të siguruar transparencë në financimin politik dhe në financimin e fushatave. Zbatimi i reformave zgjedhore të lidhura me gjininë, gjithashtu, u diskutuan gjatë një takimi të dedikuar me palët e interesuara.⁹

Është arritur përparim i kufizuar në adresimin e rekomandimeve të jashtëzakonshme nga OSBE/ODIHR¹⁰ dhe Komisioni¹¹ i Venecias. Siç është përmendur në raportet e tyre, legjislacioni zgjedhor duhet të rishikohet në mënyrë gjithëpërfshirëse në mënyrë që të zgjidhjen mospërputhjet ekzistuese, ndërsa ligjet relevante duhet të miratohen me kohë, në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe transparente, shumë përpara zgjedhjeve të ardhshme. Në këtë drejtim, autoritetet relevante duhet t'i përforcojnë përpjekjet e tyre dhe të tregojnë vullnet politik për përmirësim plotësues të procesit zgjedhor.¹²

1.3. Zhvillimet e fundit

Gjatë periudhës janar-mars 2022, u zhvilluan diskutime për reformën e Kodit Zgjedhor si përgjigje ndaj kërkesave të partive më të vogla politike të përfaqësuara në Kuvend. Kërkesat¹³ e tyre përfshijnë vendosjen e ndryshimeve në Kodin Zgjedhor, më konkretisht vendosjen e një sistemi zgjedhor prej një njësie zgjedhor me model zgjedhor proporcional pa prag zgjedhor.¹⁴ Në janar të vitit 2022, deputetët

⁶Zyra e OSBE-së për institucionet demokratike dhe të drejtat e njeriut. (v. 2022, 25 mars). *Republika e Maqedonisë së Veriut - Zgjedhjet lokale 17 dhe 31 tetor të vitit 2021: Raporti përfundimtar i Komisionit për vëzhgimin e zgjedhjeve të ODIHR-it*. E arritshme në: <https://www.osce.org/files/f/documents/9/3/514666.pdf>

⁷Komisioni Evropian. (v. 2022, 12 tetor). *Raporti për Maqedoninë e Veriut për vitin 2022: Komunikatë nga Komisioni drejtuar Parlamentit Evropian, Këshillit, Komitetit Ekonomik dhe Social Evropian dhe Komitetit të rajoneve, Komunikatë për politikën e zgjerimit të BE-së për vitin 2022*. E arritshme në: <https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2022-10/North%20Macedonia%20Report%202022.pdf>

⁸Fridomhause (v. 2022). *Raporti "Kombet në tranzit" për vitin 2022*. E arritshme në: <https://freedomhouse.org/country/north-macedonia/nations-transit/2022>

⁹Zyra e OSBE-së për institucione demokratike dhe të drejtat e njeriut. (v. 2022, 28 qershor). *Ekspertët e ODIHR-it diskutojnë rekomandimet e zgjedhjeve në Maqedoninë e Veriut*. E arritshme në: <https://www.osce.org/odihr/elections/north-macedonia/521380>

¹⁰Ibid.

¹¹Komisioni Evropian për Demokraci dhe Drejtësi (Komisioni i Venecias) dhe Zyra e OSBE-së për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut. (v. 2016, 29 shtator). *Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë: Propozim-mendmi i përbashkët për Kodin zgjedhor të ndryshuar më 9 nëntor të vitit 2015*. E arritshme në:

[https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL\(2016\)030-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL(2016)030-e)

¹²Komisioni Evropian. (v. 2022, 12 tetor). *Raporti për Maqedoninë e Veriut për vitin 2022: Komunikatë nga Komisioni drejtuar Parlamentit Evropian, Këshillit, Komitetit Ekonomik dhe Social Evropian dhe Komitetit të rajoneve, Komunikatë për politikën e zgjerimit të BE-së për vitin 2022*. E arritshme në: <https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2022-10/North%20Macedonia%20Report%202022.pdf>

¹³Partia Politike Lidhja Demokratike. (v. 2022, 29 janar). *Lidhja Demokratike: Reforma rrënjësore të rregullave zgjedhore*. E arritshme në: <https://bit.ly/3SF7JTW>

¹⁴Dojçe Vele-Maqedonia e Veriut. (v.2022, 21 janar). *Ndryshimi i modelit zgjedhor sërish në tryezë*. E arritshme në: <https://bit.ly/35qNFAV>

nga pesë parti më të vogla në koalicionin qeverisës kushtëzuan mbështetjen për qeverinë e re me kërkesën ndryshimet në Kodin zgjedhor të lidhen në tre muajt e ardhshëm dhe kërkuar nga kryetari i Kuvendit të caktojë seancë plenare sa më shpejt të jetë e mundur¹⁵. Kushti lindi për shkak se nuk u diskutua propozimi për ndryshime në Kodin zgjedhor i parashtruar 11 muaj më parë (05.03.2021) në Kuvend nga këto parti më të vogla politike.¹⁶

Deri në fund të marsit të vitit 2022, Komisioni për sistem politik dhe marrëdhënie ndërmjet bashkësive mbajti seancë në Kuvend për propozim ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Zgjedhor¹⁷, në të cilin anëtarët e komisionit mbështetën fazën e parë të propozimit për model proporcional, pa prag zgjedhor, me modelin D 'hondt të shpërndarjes së mandateve ku shteti do të ishte një njësi zgjedhore.¹⁸

Për të pasuruar diskutimin mbi ndryshimet e nevojshme në Ligjin zgjedhor, u organizua panel diskutimi¹⁹ nga Instituti liberal²⁰, ku pjesëmarrësit kryesisht shprehën nevojën për "një njësi zgjedhore në vend të gjashtë". Gjithashtu, në fillim të qershorit të vitit 2022, u organizua anektë këshillëdhënëse²¹ nga Instituti i Politikave Evropiane (EPI) ku një numër i madh qytetarësh (150 nga i gjithë vendi) diskutuan dhe u pyetën se çfarë sistemi zgjedhor ata dëshironin dhe çfarë reformash nevojiten në procesin zgjedhor në shtet. Qytetarët patën mundësinë të diskutojnë modelet zgjedhore dhe njësitë zgjedhore, si dhe të drejtën e votës së diasporës, me përfaqësuesit politikë nga partitë parlamentare dhe listat zgjedhore²² dhe regjistrimin e votuesve me palët përkatëse të interesuara²³ në këtë fushë. Sipas vlerësimit të ngjarjes, mendimi i pjesëmarrësve për përfshirje më të gjerë të publikut të gjerë në dialogun për reformat zgjedhore është mbështetur në nivel të lartë. Sipas rezultateve të anketës këshillëdhënëse, paraqiten dallimet statistikisht të rëndësishme me vlera më të larta pas debatit vetëm për çështjen se duhet të ketë një njësi zgjedhore që mbulon të gjithë territorin e shtetit, por me një përqindje të caktuar minimale të votave që partitë/kandidatët e pavarur duhet t'i marrin për të fituar mandat parlamentar.²⁴

Gjatë periudhës korrik-shtator të vitit 2022, u zhvilluan disa diskutime për reformën e Kodit zgjedhor me mbështetjen e OSBE-së të Ministrisë së Drejtësisë (MD), e cila është institucioni kryesor qeveritar që drejton diskutimet e reformës.²⁵ Ministri i Drejtësisë deklaroi gjithashtu se “është e nevojshme të njihen paraprakisht rregullat e zgjedhjeve dhe ato të mos miratohen pak para zgjedhjeve”.

Lidhur me procesin zgjedhor, Gjykata Themelore Qytetare Shkup përcaktoi diskriminim ndaj personave me aftësi të kufizuara në ushtrimin e së drejtës së votës²⁶ nga Qeveria dhe Komisioni Shtetëror të Zgjedhjeve. Ky aktgjykim është miratuar në bazë të një padie actipopularis të ngritur nga Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut të Republikës së Maqedonisë, ku Koalicioni Margjinat ishte palë e tretë.²⁷ Në të njëjtën kohë, Gjykata obligoi Qeverinë dhe Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve deri në shpalljen e zgjedhjeve të ardhshme të sigurojnë qasje në rrugë të sheshta, parkim dhe qasje në qendrat e votimit për personat me aftësi të kufizuara në qendrat e votimit ku kjo nuk ka qenë e mundur deri më tani.

¹⁵Blazhevskaja K. (v. 2022, 14 janar). *Pesë parti kanë kushtëzuar mbështetjen për Qeverinë*. Dojçe Vele. E arritshme në: <https://bit.ly/3xdbpUr>

¹⁶Ibid.

¹⁷Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut. (v.2022, 22 mars). *Sesioni nr. 39 i Komisionit për sistem politik dhe marrëdhënie ndërmjet bashkësive, i caktuar për 22 mars v. 2022 në orën 10:00*. Detaje të arritshme në: <https://bit.ly/3J36oDq>.

¹⁸Ibid.

¹⁹Nikolovski M. (v. 2022, 2 qershor). *Një njësi zgjedhore- nevojë për reformë të rrënjësishme të sistemit zgjedhor*. Televizioni *Telma*. E arritshme në: <https://bit.ly/3YeEJUj>

²⁰Instituti Liberal - Shkup. (v. 2022, 1 qershor). *Një njësi zgjedhore në vend të gjashtë sa janë tani – përfaqësimi më adekuat i votës së qytetarëve*. E arritshme në: <https://www.facebook.com/liberalinstitutemk/videos/1736530570040094>

²¹Instituti për Politikë Evropiane - Shkup. (v. 2022, 31 maj). *Qytetarët diskutojnë dhe pyesin: Sistemi zgjedhor dhe reformat në procesin zgjedhor në Maqedoninë e Veriut*. E arritshme në: <https://epi.org.mk/post/20948>

²²PavleTrajanov, Arta Bilalli-Zendeli, Dragan Kovački, Viktorija Avramovska-Madiq, si dhe përfaqësuesi i sektorit civil, Sefer Selimi.

²³Renata Deskoska, Sasho Klekovski, Halil Snopçe, Fadil Zendeli dhe Gordan Georgiev.

²⁴Instituti për Politikë Evropiane - Shkup. *Debati kombëtar për reformatzgjedhore në Maqedoninë e Veriut*. E arritshme në: https://epi.org.mk/wp-content/uploads/Summary_NED_ENG.pdf

²⁵Ministria e Drejtësisë. (v. 2022, 6 qershor). *Misioni i OSBE-së në Shkup mbështet iniciativën e Ministrisë së Drejtësisë për përgatitjen e Kodit të ri zgjedhor*. E arritshme në: <https://pravda.gov.mk/vest/6365>

²⁶Stojkova I. (v. 2022, 7 shtator). *Aktgjykimi - shteti ka diskriminuar personat me aftësi të kufizuara në realizimin e së drejtës së votës*. *Radio Evropa e Lirë (në gjuhënmaqedonase)*. E arritshme në: <https://bit.ly/3Sz4rjx>

²⁷Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Maqedoninë e Veriut. (v. 2022, 1 shtator). *Qeveria dhe Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve kanë kryer diskriminim të drejtpërdrejtë për personat me aftësi të kufizuara gjatë realizimit të së drejtës së tyre për të votuar*. E arritshme në: <https://bit.ly/3f7WWmb>

Në periudhën prill – qershor të vitit 2022, partia më e madhe opozitare parlamentare, VMRO-DPMNE, vazhdimisht kërkonte zgjedhje të parakohshme parlamentare dhe merrej në bllokimin e punës së Kuvendit. Ata gjithashtu kërkuan takim të liderëve midis udhëheqësve të dy partive më të mëdha parlamentare për shkak të përkeqësimit të krizës ekonomike dhe energjetike²⁸. Kjo kërkesë u refuzua nga kryeministri Kovaçevski dhe kreut të partisë në pushtet me arsyetimin se nuk ishte koha e duhur për të mbajtur zgjedhje të parakohshme parlamentare. Në të njëjtën kohë, kryeministri Kovaçevski theksoi se qeveria planifikonte të mbante zgjedhje të rregullta siç ishte planifikuar për vitin 2024, të cilat do të mbaheshin në të njëjtin vit me zgjedhjet presidenciale.²⁹

Në raport me zgjedhjet lokale në vitin 2021, ekzistonte rreziku i shpërbërjes së Këshillit të Komunës së Tetovës³⁰, gjë që përfundimisht ndodhi kur Qeveria e Maqedonisë së Veriut shkarkoi Këshillin e Komunës. Arsyeja kryesore për këtë hap ishte mosmiratimi i llogarisë vjetore të buxhetit komunal për vitin 2021.³¹ Nga Komuna reagues se shkarkimi i Këshillit ishte i paligjshëm për shkak se kishte skaduar afati për shkarkimin e Këshillit, por konfirmuan se duhet të mbahen zgjedhje të reja për këshilltarë.³² Pas mbajtjes së zgjedhjeve të reja për Këshillin e Komunës së Tetovës në gusht të vitit 2022, anëtarët e pavarur të Këshillit të zgjedhur më parë mbetën pa mandatet e tyre.³³

Zgjedhjet lokale të vitit 2021 demonstuan edhe një herë përfaqësimin e dobët të grave, pasi në vend u zgjodhën vetëm dy kryetare komunash, krahasuar me 79 kryetarë komunash. Pavarësisht këmbënguljes ndaj pengesave për pjesëmarrjen politike të grave, epilogu i vitit 2021 ishte rezultat i mungesës së kuotave për përfaqësim gjinor në nivelin e kryetarëve të komunave.³⁴

Në hulumtimin e zbatuar nga Instituti Ndërkombëtar Republikan (IRI), rezultatet e të cilit u botuan në fund të dhjetorit të vitit 2022, shumica e qytetarëve, ose gjithsej 70% (39% - me shumë gjasa; 31% - me gjasa), do të votonin nëse zgjedhjet do të mbaheshin nesër, ndërsa për momentin mbështetjen më të madhe ia japin partisë kryesore opozitare VMRO-DPMNE (19%), derisa LSDM-ja në pushtet shënon rënie në mbështetje dhe ka rejting prej vetëm 11%.³⁵

1.4. Rekomandimet

- Qeveria duhet të tregojë vullnet politik për të përmirësuar procesin zgjedhor, duhet të ketë një proces të gjerë konsultativ për reformën zgjedhore. Propozimet ekzistuese janë të paqarta pa hulumtim të thelluar se çfarë do të nënkuptonin ato ndryshime për demokracinë e shtetit, derisa për opinionin mesazhet janë habitëse, gjë që nga ana tjetër shkakton konfuzion në mesin e popullatës më të gjerë.
- Legjislacioni zgjedhor duhet të ndryshohet për t'iu përgjigjur rekomandimeve të OSBE/ODIHR-it me diskutim thelbësor në Kuvend, debate publike dhe procedurë normale.
- Ligjet relevante duhet të miratohen me kohë, në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe transparente.

²⁸Lazova A. (v. 2022, 8 maj). *Nuk do të ketë takim të liderëve për zgjedhje të parakohshme parlamentare*. Kanali 5. E arritshme në: <https://kanal5.com.mk/nema-da-ima-liderska-sredba-za-predvremeni-parlamentarni-izbori/a528975>

²⁹TV 21. (v. 2022, 6 maj). *"Zgjedhje do të ketë në vitin 2024," shprehet Kovaçevski*. E arritshme në: <https://en.tv21.tv/izbori-ke-ima-vo-2024-godina-veli-kovacevski/>

³⁰Blazhevski B. (v. 2022, 29 prill). *Portalb: Këshilli i Komunës së Tetovës para shpërndarjes, është e paqartë nëse do të ketë zgjedhje të reja*. Meta.MkE arritshme në: <https://meta.mk/portalb-sovetot-na-opstina-tetovo-pred-raspushtanje-nejasno-e-dali-kje-ima-novi-izbori/>

³¹Ligji për financimin e NJVL-ve rregullon miratimin e llogarive vjetore për buxhetin nga viti paraprak deri më 31 mars të vitit paraprak. E arritshme në: <https://finance.gov.mk/wp-content/uploads/2009/02/Zakon-za-finansiranje-na-edinicite-na-lokalna-samouprava-Precisten-tekst.pdf>

³²Alsat M. (v. 2022, 14 qershor). *Qeveria ka shpërndarë Këshillin e Komunës së Tetovës*. E arritshme në: <https://alsat.mk/en/najnova-vest-vladata-go-raspushti-sovetot-na-opstina-tetovo/>

³³SDK.MK (v. 2022, 21 gusht). *BESA ka 12 këshilltarë në Këshillin e Tetovës, ndërsa BDI 11, VMRO-DPMNE dhe LSDM kanë numër të njëjtë si një zgjedhjet e vitit të kaluar*. E arritshme në: <https://sdk.mk/index.php/dopisna-mrezha/besa-osvoi-12-sovetnitsi-vo-sovetot-na-tetovo-a-dui-11-vmro-dpmne-i-sdsm-imaat-ist-broj-kako-na-lanskite-izbori/>

³⁴Fondacioni Ndërkombëtar i Sistemeve Zgjedhore (IFES). (v. 2022) *Pjesëmarrja e grave në proceset politike në Maqedoninë e Veriut*. E arritshme në: <https://electoralreforms.mk/wp-content/uploads/2022/06/ENG-Study-on-womens-participation-in-political-processes-in-North-Macedonia.pdf>

³⁵Instituti Ndërkombëtar Republikan (IRI). (v. 2022, 19 dhjetor). *Anketa Kombëtaree Maqedonisë së Veriut - shtator-tetor v. 2022* E arritshme në: <https://bit.ly/3PNIAq3>.

Kapitulli 2 – MBROJTJA E PAKICAVE KOMBËTARE

2.1. Standardet dhe legjislacioni ndërkombëtar

Maqedonia e Veriut është vend multietnik dhe grupet e saj kryesore etnike sipas Kushtetutës janë populli maqedonas, si dhe qytetarët që jetojnë brenda kufijve të saj, të cilët janë pjesë e popullit shqiptar, popullit turk, popullit vllah, popullit serb, popullit rom, popullit boshnjak dhe të tjerëve.³⁶ Ka shumë mendime se vendi funksionon përmes bashkësive të ndara dhe të veçuara me përkatësi etnike si vija primare të ndarjes.

Maqedonia e Veriut ka ratifikuar marrëveshjet kryesore ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, duke përfshirë edhe Konventën e KB-ve për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor; Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, Konventën kornizë për mbrojtjen e pakicave kombëtare, Udhëzimet e Lubjanës për Integrimin e shoqërive të ndryshme të OSBE-së, të gjitha konventat fundamentale të OKB-së dhe KE-së për të drejtat e njeriut. Standardet ndërkombëtare e të drejtave të njeriut të ratifikuara nga vendi kanë prioritet mbi legjislacionin kombëtar. Maqedonia e Veriut është zotuar për Kartën evropiane për gjuhët rajonale ose minoritare, por ende nuk e ka ratifikuar atë.³⁷

Kushtetuta përfshin parimin e barazisë dhe ndalon diskriminimin, duke përfshirë edhe në bazë të prejardhjes racore dhe etnike. Për më tepër, Marrëveshja kornizë e Ohrit, e cila i dha fund konfliktit të armatosur në vitin 2001, parashikon një varg masash legjislative dhe politike në mënyrë që të sigurojë barazinë dhe mbrojtjen e bashkësive joshumicë³⁸, në mesin e të cilave edhe statusi zyrtar i gjuhës shqipe në fushat ku të paktën 20 për qind e popullsisë flet gjuhën, përfaqësimin e drejtë dhe proporcional, arsimin e përforcuar në gjuhën shqipe, rregullin e miratuar për "shumicë të dyfishtë"³⁹ dhe përmirësimin e pjesëmarrjes dhe punësimit të bashkësive joshumicë në jetën publike dhe institucionet shtetërore. Pasqyra e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit për kohezionin social (MKO) të përgatitur në vitin 2015 tregon situatën e brishtë ndëretnike, mungesën e besimit ndërmjet bashkësive dhe nevojën për fokusim të vazhdueshëm në kohezionin social.⁴⁰

Në vitin 2019, Qeveria e Maqedonisë së Veriut miratoi Strategjinë "Një shoqëri për të gjithë", e cila ka për qëllim të zhvillojë në mënyrë plotësuese komunikimin ndërkulturor ndërmjet kulturave dhe bashkësive të ndryshme të saj dhe ta zbatojë atë si vegël për të zbatuar rekomandimet e organeve ndërkombëtare, të tilla si Kombet e Bashkuara, Këshilli i Evropës, Komisioni Evropian dhe Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë.

2.2. Gjendja momentale

Sipas raportit të KE-së për vendit për vitin 2022, në raport me mbrojtjen e bashkësive joshumicë, autoritetet vazhduan të zbatojnë strategjinë kombëtare "Një shoqëri për të gjithë dhe interkulturalizëm". Komisioneri i Lartë i OSBE-së për pakicat kombëtare, gjithashtu, shprehu mbështetjen e tij për përpjekjet e vazhdueshme të Maqedonisë së Veriut për të zhvilluar strategjinë

³⁶Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut. E arritshme në: https://www.sobranie.mk/the-constitution-of-the-republic-of-macedonia-ns_article-constitution-of-the-republic-of-north-macedonia.nsp

³⁷Këshilli i Evropës, Promovimi i ratifikimit të Kartës evropiane për gjuhë rajonale dhe të pakicave e arritshme në: <https://www.coe.int/en/web/european-charter-regional-or-minority-languages/promoting-ratification>

³⁸Terminologjia e miratuar nga Marrëveshja Kornizë e Ohrit është "bashkësitë joshumicë".

³⁹Vendimet parlamentare i prekin të drejtat e bashkësive ose vetëqeverisjen lokale duhet të miratohen edhe me shumicën e deputetëve dhe me shumicën e votave nga deputetët e bashkësive joshumicë.

⁴⁰Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Sekretariati për Zbatimin e MKO (v. 2015). Pasqyrë e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit për kohezionin social. E arritshme në: <https://www.eip.org/wp-content/uploads/2020/07/OFA-Review-on-Social-Cohesion.pdf>

Një shoqëri për të gjithë si kornizë efektive për të ndihmuar në përmirësimin e kohezionit social. KE-ja beson se marrëdhëniet ndëretnike janë bërë të qëndrueshme, ndërsa Marrëveshja Kornizë e Ohrit vazhdon të zbatohet, derisa Këshilli i Evropës thekson se megjithëse marrëdhëniet ndëretnike janë përmirësuar, linjat ndarëse etnike dhe gjuhësore shfaqen në sipërfaqe në kohë krize. Për të siguruar qëndrueshmërinë e Strategjisë "Një shoqëri për të gjithë", e cila merr një qasje të vlefshme ndërkulturore, nevojitet mbështetje më e madhe politike e nivelit të lartë dhe financim solid.⁴¹

Komiteti këshillimor për Konventën kornizë të Këshillit të Evropës për mbrojtjen e pakicave kombëtare, në mendimin e tij të pestë për Maqedoninë e Veriut në vitin 2022, përcaktoi se ka pasur përparim në mbrojtjen juridike të pakicave kombëtare përmes përmirësimit të politikave të saj në përputhje me Konventën kornizë, por zbatimin e tyre praktik duhet të përmirësohet. Komiteti i Këshillit të Evropës bën disa rekomandime për Maqedoninë e Veriut që synojnë forcimin e mëtejshëm të antidiskriminimit dhe barazisë, mbrojtjen e pakicave kombëtare nga armiqësia dhe dhuna, promovimin e kulturave të tyre, përmirësimin e arsimit dhe përfaqësimit të tyre mediatik, si dhe të drejtat e tyre gjuhësore, të punës dhe banimit.

Sipas Raportit të SHBA-së për gjendjen e të drejtave të njeriut në vend për vitin 2021⁴², pjesëtarët e grupeve më të vogla të pakicave etnike vazhduan të ankohen për përfaqësim të padrejtë në Qeveri dhe politika diskriminuese që i përjashtonin ata nga pjesëmarrja politike. Në kabinetin qeveritar prej 20 anëtarësh kishte tetë ministra që janë shqiptarë etnikë. Që nga 1 nëntori i vitit 2021, në Kuvend kishte 32 deputetë shqiptarë etnikë, duke përfshirë edhe kryeparlamentarin dhe tre turq, dy serbë, një rom, një vllah, një boshnjak dhe një deputet hebre.

Zbatimi i Ligjit për përdorimin e gjuhëve vuan nga një hendek i konsiderueshëm midis përdorimit të gjuhës shqipe dhe situatës praktike në administratën dhe gjykatat. Në mënyrë që të korrigjohet kjo, nevojiten investime të konsiderueshme në trajnimin dhe rekrutimin e përkthyesve dhe stafit dygjuhësor.

Autoriteteve, gjithashtu, u është bërë thirrje të rrisin pjesëmarrjen socio-ekonomike të pjesëtarëve të pakicave kombëtare që jetojnë në zonat rurale përmes investimit në infrastrukturë dhe mundësi punësimi për të rinjtë nga bashkësitë joshumicë.

2.3. Zhvillimet e fundit

Dy dekada pas regjistrimit të fundit kombëtar të popullsisë, në shtator të vitit 2021, vendi më në fund zbatoi regjistrimin e popullsisë dhe amvisërive⁴³, ndërsa të dhënat u publikuan në fund të marsit të vitit 2022, pas një analize disamujore të të dhënave.

Sipas Entit Shtetëror të Statistikave⁴⁴, popullsia e përgjithshme rezidente është 1.836.713 banorë. Popullsia e përgjithshme jorezidente, e cila përfshin shtetasit e Republikës së Maqedonisë së Veriut që mungojnë jashtë vendit për më shumë se 12 muaj dhe të huajt të pranishëm përkohësisht në Republikën e Maqedonisë së Veriut për më pak se 12 muaj, arrin në 260.606 persona të përfshirë në regjistrimin.

Nga popullsia e përgjithshme e regjistruar, 54,21% janë deklaruar si maqedonas, 29,52% si shqiptarë, 3,98% si turq, 2,34% si romë, 1,18% si serbë, 0,87% si boshnjakë dhe 0,44% si vllahë.

⁴¹Komiteti Këshillimor për Konventën kornizë për mbrojtjen e pakicave kombëtare (v. 2022, 21 shtator). Mendimi i pestë për Maqedoninë e Veriut. E arritshme në: <https://rm.coe.int/5th-op-north-macedonia-en/1680a82967>

⁴²Departamenti i Shtetit i SHBA-së (v. 2022, 27 prill). Raport mbi gjendjen e të drejtave të njeriut në Maqedoninë e Veriut për vitin 2021. E arritshme në: https://www.state.gov/wp-content/uploads/2022/02/313615_NORTH-MACEDONIA-2021-HUMAN-RIGHTS-REPORT.pdf.

⁴³Enti Shtetëror i Statistikës. (v. 2022, 30 mars). *Popullsia e përgjithshme rezidente e Republikës së Maqedonisë së Veriut është 1.836.713 banorë. Regjistrimi i popullsisë i vitit 2021*. E arritshme në: <https://bit.ly/3uXf13D>

⁴⁴Enti Shtetëror i Statistikës. (v. 2022, 30 mars). *Regjistrimi i popullsisë, amvisërive dhe banesave në Republikën e Maqedonisë së Veriut, viti 2021 - baza e parë e të dhënave. E arritshme në: https://www.stat.gov.mk/PrikaziSoopstenie_en.aspx?rbtxt=146*

Nga popullsia e përgjithshme rezidente në Republikën e Maqedonisë së Veriut, 58,44% e popullsisë janë deklaruar si maqedonas, 24,30% si shqiptarë, 3,86% si turq, 2,53% si romë, 0,47% si vllahë, 1,30% si serbë dhe 0,87% si boshnjakë.

Në popullsinë e përgjithshme jorezidente të përfshirë në regjistrimin, që përfshin shtetasit e Republikës së Maqedonisë së Veriut që mungojnë jashtë vendit për më shumë se 12 muaj dhe të huajt të pranishëm përkohësisht në Republikën e Maqedonisë së Veriut për më pak se 12 muaj, 24,45% janë deklaruar si maqedonas, 66,36% si shqiptarë, 4,79% si turq, 1,02% si romë, 0,19% si vllahë, 0,35% si serbë, 0,81% si boshnjakë dhe të tjerë.

Një nga konkluzionet kryesore nga regjistrimi është se popullsia është ulur për rreth 10%. Përkundër faktit se Qeveria e cilësoi këtë proces si të suksesshëm, opozita shprehu shqetësim, duke thënë se regjistrimi nuk ishte i plotë. Me fjalë tjera, VMRO-DPMNE-ja pohon se 7,2% nuk janë regjistruar dhe se të dhënat janë marrë nga bazat e të dhënave. Bashkësitë⁴⁵ joshumicë gjithashtu shprehën pakënaqësinë e tyre nga procesi.⁴⁶

Në përputhje me konkluzionet e Këshillit Evropian të korrikut të vitit 2022, Maqedonia e Veriut duhet të ndryshojë Kushtetutën e saj për të përfshirë qytetarët që jetojnë brenda kufijve të shtetit dhe që janë pjesë e popujve të tjerë, siç janë bullgarët.⁴⁷ Diskutimi për ndryshimet kushtetuese ishte në rrjedhë në momentin e shkrimit të këtij raporti dhe është kusht për mbajtjen e konferencës së dytë ndërqeveritare me Bashkimin Evropian dhe vazhdimin e bisedimeve aderuese në tërësi.

2.4. Përfaqësimi i drejtë

Në janar të vitit 2022, Avokati i Popullit prezantoi Raportin⁴⁸ e monitorimit për zbatimin e parimit të përfaqësimit të drejtë për vitin 2020⁴⁹, i cili u publikua në dhjetor të vitit 2021. Sipas raportit për periudhën 2007 – 2020, ka një përmirësim të përgjithshëm në raport me respektimin e përcaktimit kushtetues;⁵⁰ mirëpo, tendenca e përfaqësimit të pakënaqshëm të bashkësive më të vogla në ministrinë ekziston ende, veçanërisht në pozitat udhëheqëse.⁵¹ Përveç kësaj, zbatimi i parimit të përfaqësimit të drejtë nuk respektohet në gjyqësor dhe prokurori.⁵² Raporti i KE-së për vendin për vitin 2022 është i ngjashëm, meqë konstatoi se përfaqësimi i drejtë i bashkësive joshumicë mbetet jokonsistent në sektorin publik dhe në të gjitha kategoritë e nëpunësve shtetërorë. Raporti paraqet shqetësimin, duke përfshirë edhe nga Enti Shtetëror i Statistikës, në lidhje me nismën e Ministrisë së Shoqërisë Informatike dhe Administratës për rishikimin e përqindjes në formulën e të ashtuquajturit “Balances”, vegël kjo për burime njerëzore që përcakton përqindjen e të punësuarve në sektorin publik nga secili grup etnik. Përveç kësaj, nuk ka përfunduar transferimi i të punësuarve nga Ministria e Sistemit Politik dhe Marrëdhënieve me Bashkësitë në institucione të ndryshme, gjë që vazhdoi të minojë parimet e meritës dhe efektivitetit.

⁴⁵Kanali 5. (v.2022, 30 mars). *Miloshoski: Numrat nga regjistrimi i popullsisë janë disfatuese, ndërsa operacioni i pakompletuar*. E arritshme në: <https://kanal5.com.mk/miloshoski-brojkite-od-popisot-se-porazitelni-a-operacijata-nekompletua/a523370>

⁴⁶360 Gradë. (v. 2022, 31 mars). Partia për lëvizjen e turqve kërkon që Ligji për përdorimin e gjuhëve të zbatohet në përputhje me rezultatet e regjistrimit. E arritshme në: <https://bit.ly/3LA5VqG>

⁴⁷Shih Konkluzionet e Këshillit të Bashkimit Evropian më 18 korrik të vitit 2022. E arritshme në: <https://data.consilium.europa.eu/doc/document/ST-11440-2022-INIT/en/pdf>

⁴⁸Avokati i Popullit i Republikës së Maqedonisë së Veriut. (v. 2022, 28 janar). Konferencë për mediae *Avokatit të Popullit z. Naser Ziberi mbi gjendjen e nivelit të respektimit të parimit të përfaqësimit adekuat dhe të drejtë të bashkësive*. E arritshme në: <https://bit.ly/3kKseSH>

⁴⁹Avokati i Popullit i Republikës së Maqedonisë së Veriut. (v. 2021, dhjetor). Raport mbi ndjekjen *gjendjes me zbatimin e parimit të përfaqësimit adekuat dhe të drejtë për vitin 2020*. E arritshme në: <https://bit.ly/3ra6jnZ>.

⁵⁰Ibid.

⁵¹Ibid.

⁵²Ibid.

Avokati i popullit prezantoi edhe gjetjet nga Raporti i posaçëm për gjendjen e përfaqësimit gjinor e të punësuarve në sektorin publik në vitin 2020, me ç'rast gjetjet tregojnë përmirësim të nivelit të barazisë gjinore, për dallim nga vitet paraprake, me përjashtim të pozicioneve udhëheqëse.⁵³

2.5. Grupet e rrezikuara dhe parimi i mosdiskriminimit

Komisioni për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi (KPMD) kontribuoi në konsultimet e Komisionit Evropian për zhvillimin e standardeve për trupat për barazi.⁵⁴ Gjatë periudhës prill – qershor të vitit 2022, KPMD filloi procedurë sipas detyrës zyrtare kundër një funksionari publik, me rastin e deklaratave të tij në një emision debativ televiziv, duke bërë të ditur në ngacmimin etnik të pjesëtarëve të bashkësisë etnike turke në Republikën e Maqedonisë së Veriut.⁵⁵

KPMD mori vlerësim pozitiv për punën e vet në raportin e fundit të Departamentit të Shtetit.⁵⁶ Sipas raportit, në vitin 2021 KPMD punonte në mbrojtjen e qytetarëve nga shkelja e të drejtave të tyre nga institucionet publike, ulja e diskriminimit kundër bashkësive pakica dhe personave me aftësi të kufizuar, promovimin e përfaqësimit të drejtë në jetën publike dhe parandalimin e keqpërdorimit të të drejtave të fëmijëve.⁵⁷

Për më tepër, KPMD mori pjesë në përgatitjen e Raportit të katërt periodik për Republikën e Maqedonisë së Veriut në përputhje me Paktin Ndërkombëtar për të drejtat civile dhe politike të të KB-ve, i cili erdhi si rrjedhojë e pjesëmarrjes së KPMD në raportin në përputhje me Konventën për eliminimin e diskriminimit racor.⁵⁸

Nga mesi i qershorit, KPMD nënshkroi Memorandume bashkëpunimi me Frontin subversiv dhe Institutin për qeverisje të mirë dhe perspektiva euroatlantike (IQMPE), me qëllim të realizimit të përpjekjeve të përbashkëta për të forcuar bashkëpunimin dhe mbështetjen e ndërsjellë në përpjekjet për përballje me gjuhën diskriminuese dhe dukuritë tjera negative në internet.⁵⁹

Nga fundi i korrikut, KPMD dhe Kabineti i Presidentit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nënshkruan një Memorandum bashkëpunimi me qëllim të ndërmarrjes së aktiviteteve të koordinuara për të avancuar mbrojtjen nga diskriminimi dhe për të siguruar gëzimin e plotë dhe të barabartë të të gjitha të drejtave të njeriut dhe lirive themelore për të gjithë qytetarët e Republikës së Maqedonisë së Veriut.⁶⁰

Mendimi i ri i Komitetit Këshillimor të Konventës Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare bën të ditur se Maqedonia e Veriut ka arritur përparim të konsiderueshëm në mbrojtjen juridike e të drejtave të personave që u përkasin pakicave kombëtare, veçanërisht në fushën e antidiskriminimit dhe

⁵³Komisioni Evropian. (v. 2022, 12 tetor). Raporti 1për Maqedoninë e Veriut për vitin 2022: Komunikatë nga Komisioni drejtuar Parlamentit Evropian, Këshillit, Komitetit Ekonomik dhe Social Evropian dhe Komitetit të rajoneve, Komunikatë për politikën e zgjerimit të BE-së për vitin 2022. E arritshme në: <https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2022-10/North%20Macedonia%20Report%202022.pdf> || UNTRANSLATED_CONTENT_END ||

⁵⁴Komisioni për Parandalim dhe Mbrojtje nga Diskriminimi. (v. 2022, 16 mars). *Rëndësia, roli dhe sfidat e barazisë në promovimin e barazisë dhe luftimin e diskriminimit. Kontributi në procesin e konsultimit publik "Trupa për barazi - standarde detyruese"*. E arritshme në: <https://kszd.mk/wp-content/uploads/2022/03/CPD-Contribution-EC.pdf>

⁵⁵Komisioni për Parandalim dhe Mbrojtje nga Diskriminimi. (v. 2022, 18 prill). Procedura e nisur sipas detyrës zyrtare ndaj Valon Belës. E arritshme në: <https://bit.ly/3SISQj>

⁵⁶Departamenti i Shtetit i SHBA-së (v. 2022, 27 prill). Raport mbi gjendjen e të drejtave të njeriut në Maqedoninë e Veriut për vitin 2021. E arritshme në: https://www.state.gov/wp-content/uploads/2022/02/313615_NORTH-MACEDONIA-2021-HUMAN-RIGHTS-REPORT.pdf.

⁵⁷Komisioni për Parandalim dhe Mbrojtje nga Diskriminimi. (v. 2022, 18 prill). Vlerësim pozitiv i punës së KPMD-së në Raopirtin e Departamentit të Shtetit për vitin 2021. E arritshme në: <https://bit.ly/3EPeJYJ>

⁵⁸Komisioni për Parandalim dhe Mbrojtje nga Diskriminimi. (v. 2022, 18 prill). KPMD-ja është përfshirë në përpilimin e "Raporteve shtetërore të Paktit Ndërkombëtar të OKB-së". E arritshme në: <https://bit.ly/41QpUdV>

⁵⁹Komisioni për Parandalim dhe Mbrojtje nga Diskriminimi. (v. 2022, 15 qershor). KPMD nënshkroi Memorandum bashkëpunimi me Frontin Subversiv dhe IDUEP. E arritshme në: <https://bit.ly/41Ar78S>

⁶⁰Komisioni për Parandalim dhe Mbrojtje nga Diskriminimi. (v. 2022, 25 korrik). KPMD dhe Kabineti i Presidentit të Republikës së Maqedonisë nënshkruan Memorandum bashkëpunimi. E arritshme në: <https://bit.ly/3DeVeqS>

përdorimit të gjuhës shqipe. Ata shtojnë se në nivel politik, strategjia "Një shoqëri për të gjithë" siguron një udhërrëfyes të vlefshëm drejt një shoqërie të integruar multietnike dhe është në përputhje me parimet e Konventës kornizë meqë promovon respektimin e diversiteteve përmes dialogut interkulturore. Mirëpo, zbatimi praktik i legjislacionit dhe politikave për pakicat kombëtare duhet të përmirësohet.⁶¹

Raporti i KE-së për Maqedoninë e Veriut për vitin 2022 përsëriti çështjet e njëjta nga raportet e mëparshme për vendin, meqë ato janë sfida të shumta logjistike dhe financiare që pengojnë punën e KPMD-së. Për më tepër, u konkludua se Qeveria përsëri ka shkurtuar buxhetin vjetor të KPMD-së, ndërsa ende ka mungesë të stafit administrativ. Ka vërejtje edhe për mungesën e pavarësisë së KPMD-së në lidhje me shpenzimin e buxhetit për shkak të mospërputhjes së kornizës aktuale ligjore dhe mungesës së diversitetit në përbërjen e KPMD-së, veçanërisht në raport me gjininë dhe personat me aftësi të kufizuara.⁶²

Në fillim të nëntorit, pas dorëheqjes së presidentit dhe anëtarit të KPMD-së, anëtarët e KPMD-së zgjedhën president dhe nënkryetar të ri.⁶³ Momentalisht, në KPMD ka dy vende të lira. Më 15 shkurt të vitit 2023, Kuvendi shpalli thirrje për zgjedhjen e anëtarëve të rinj të KPMD-së, deri në finalizimin e këtij dokumenti, Komisioni për zgjedhje dhe emërim në Kuvend dështoi në caktimin e seancës dhe organizimin e debatit publik për përzgjedhjen e kandidatëve dhe plotësimin e KPMD-së me shtatë anëtarë.⁶⁴

2.6. Gjuha e urrejtjes

Sipas Komitetit Këshillimor të KKMPK⁶⁵, korniza juridike për luftë kundër gjuhës së urrejtjes dhe krimeve nga urrejtja është përmirësuar në mënyrë plotësuese, por zbatimi i saj mbetet edhe më tej i pakënaqshëm dhe gjuha e urrejtjes, veçanërisht në internet, është problem serioz. Ka pasur disa raste të shkeljeve të të drejtave të njeriut nga autoritetet policore, por sanksionet kundër nëpunësve të policisë janë të rralla. Prandaj, Maqedonisë së Veriut i bëhet thirrje të kujdeset që krimet nga urrejtja dhe gjuha e urrejtjes të hetohen në mënyrë efektive dhe të forcohen mekanizmat mbikëqyrës për përballje me sjelljen e policisë.⁶⁶

Sipas raportit nga ndjekja e gjuhës së urrejtjes në internet kundër romëve, të zbatuar nga Instituti për hulumtime dhe analiza të politikave "Romalitiko" dhe Asociacioni Rajonal Rinor Arsimor i Romëve (RROMA)⁶⁷, u konstatua se gjuha më e zakonshme e urrejtjes në internet kundër romëve haset në Fejbuk. Është dhënë edhe rekomandim që institucionet të njoftohen me termin "anticiganizëm" si formë specifike e racizmit ndaj romëve. Ky term u pranua zyrtarisht nga Qeveria në Strategjinë e re të Romëve.⁶⁸

⁶¹RadioMOF. (v. 2022, 21 shtator). *Maqedonia e Veriut ka arritur përparim të konsiderueshme në mbrojtjen juridike të pakicave*. E arritshme në: <https://www.radiomof.mk/s-makedonija-postigna-znachitelen-napredok-vo-pravnata-zashtita-namalcinstvata/>

⁶²Komisioni për Parandalim dhe Mbrojtje nga Diskriminimi. (v. 2022, 18 tetor). *KPMD në Raportine Komisionit Evropian*. E arritshme në: <https://bit.ly/3ZEAS50>

⁶³Komisioni për Parandalim dhe Mbrojtje nga Diskriminimi. (v. 2022, 3 nëntor). *KPMD me kryetar të ri*. E arritshme në: <https://bit.ly/3klkxls>

⁶⁴Rrjeti për Mbrojtje nga Diskriminimi. *Kuvendi duhet të zgjedhë urgjentisht anëtarët e ri të KPMD*. E arritshme në: https://mzd.mk/en/vesti/sobranie_izbor_kszd/

⁶⁵Komiteti Këshillimor për Konventën kornizë për mbrojtjen e pakicave kombëtare (v. 2022, 21 shtator). *Mendimi i pestë për Maqedoninë e Veriut*. E arritshme në: <https://rm.coe.int/5th-op-north-macedonia-en/1680a82967>

⁶⁶bid.

⁶⁷Asociacioni Rajonale Arsimor dhe Rinor "Roma" dhe Instituti për hulumtime dhe analiza të politikave "Romalitiko" (v. 2021, dhjetor). *Raporti maqedonas nga monitoringui gjuhës së urrejtjes onlajn ndaj romëve*. E arritshme në: <https://bit.ly/3DMSMb4>

⁶⁸Instituti për hulumtime dhe analiza të politikave - Romalitiko. (v. 2022, 18 shkurt). *Konferenca "Gjuha e urrejtjes kundër bashkësisë së romë në sferën onlajn si pjesë e anticiganizmit"*. E arritshme në: <https://romalitiko.org/index.php/en/vesti/93-news/press-releases/471-konferencija-govor-omraza-kon-romi-mediumi>

Kohët e fundit, u bënë ndryshime në Kodin Penal, ndërsa vepra "urrejtje e bazuar në një ligj ose marrëveshje të ratifikuar ndërkombëtare" u shtua në krimet nga urrejtja, në përputhje me luftën kundër gjuhës së urrejtjes që do të vendoset në mesin e segmenteve kryesore të protokollit dypalësh të nënshkruar kohët e fundit nga Shkupi dhe Sofja. Gjuha e urrejtjes nuk do të hyjë në kompetencën e diplomacisë, por vetëm institucionet kompetente do të vlerësojnë atë që konsiderohet gjuhë e urrejtjes dhe në raste të tilla do të veprojnë në përputhje me ligjin, e kjo nuk duhet të lidhet vetëm me Bullgarinë, siç sqaruan ministri i Punëve të Jashtme dhe ministri i Drejtësisë.⁶⁹

Komisioneri i Lartë për të Drejtat e Njeriut shprehu shqetësimin e vet se festimi shtetëror i përvjetorit të nënshkrimit të Marrëveshjes së Ohrit të organizuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në vend që të kishte karakter unifikues, është edhe një shkas për përhapjen e urrejtjes dhe intolerancës ndëretnike. Publikimi i prezantueses në gjuhën maqedonase, e cila u fishkëllua nga të pranishmit, kundërshtoi drejtpërdrejt idenë e një festivali multikulturor dhe shkaktoi urrejtje midis bashkësive etnike në vend.⁷⁰

2.7. Romët

KE konsideron se ka pasur përparim të caktuar në drejtim të përfshirjes së romëve. Është miratuar strategjia e re për inkluzion të romëve për vitet 2022-2030. Qeveria shqyrtoi dhe miratoi Planin kombëtar të veprimit për mbrojtjen, avancimin dhe përmbushjen e të drejtave të njeriut të grave dhe vajzave romë për vitet 2022-2024⁷¹. Strategjia e re është udhëhequr nga Deklarata e Poznanit për integrimin e romëve në procesin e zgjerimit të BE-së⁷² dhe duke ndjekur udhëzimet e dhëna nga Korniza Strategjike e BE-së për romët.⁷³ Përveç kësaj, Qeveria caktoi këshilltar të kryeministrit përgjegjës për çështjet e përfshirjes së romëve. Pas miratimit të Strategjisë, ministrja e Punës dhe Politikës Sociale organizoi takim dyditor pune në të cilin prezantoi projektet dhe zgjidhjet ligjore që synojnë arritjen e qëllimeve konkrete, veçanërisht në fusha të tilla si arsimi, punësimi, banimi dhe sigurimi i dokumenteve personale për personat që nuk i kanë ato.⁷⁴ Në takim u theksuan edhe përgatitjet për zbatimin e agjendës së gjelbër dhe digjitale dhe mënyrat për përfshirjen e romëve në to.^{75 76}

Segregacioni në shkolla mbetet i lartë. Më 13 dhjetor të vitit 2022, GJEDNJ miratoi aktgjykim me të cilat përcaktoi se dy shkolla fillore, "Gjorgji Sugarev" në Manastir dhe "Goce Delçev" në Shtip, shkelën të drejtën e mosdiskriminimit (neni 14) në lidhje me të drejtën për arsimim (paragrafi 2 i Protokollit 1) të fëmijëve romë. Me fjalë tjera, fëmijët për disa vjet kanë mësuar në klasa gjithnjë e më të ndara, një trend ky që ka përfunduar me klasa të përbëra tërësisht nga fëmijë romë sepse prindërit e nxënësve

⁶⁹S. Hristovska Ugrinovska (v. 2022, 26 korrik). Gjuha e urrejtjes gjykohet vetëm gjatë formave më të vështira.

Slobodenpeçat.E arritshme në: <https://www.slobodenpecat.mk/govorot-na-omraza-kje-se-sudi-samo-pri-najteshkite-formi/>

⁷⁰Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut të Republikës së Maqedonisë. (v. 2022, 17 gusht). Kërkojmë dënim publik të përhapjes së urrejtjes ndëretnike. E arritshme në: <https://mhc.org.mk/news/barame-javna-osuda-za-shirenjeto-meguetnichka-omraza/>

⁷¹Ministria e Punës dhe Politikës Sociale. (v. 2021, nëntor). Plani kombëtar i veprimit për mbrojtjen, promovimin dhe përmbushjen e të drejtave të njeriut të grave dhe vajzave romë 2022-2024. E arritshme në: <https://bit.ly/3m7lWvF>

⁷²Këshilli rajonal i Bashkëpunimit. (v. 2019, 5 korrik). Deklarata e partnerëve të Ballkanit Perëndimor për integrimin e romëve në procesin e zgjerimit të BE-së. E arritshme

në: <https://www.rcc.int/romaintegration2020/files/admin/docs/866ab25893dd6d9271ebccbfd195349e.pdf>

⁷³Komisioni Evropian. (v. 2020, 7 tetor). Udhëzime për planifikimin dhe zbatimin e kornizave strategjike kombëtare për romët. E arritshme në: https://commission.europa.eu/document/01d77607-55ef-4536-b08c-394e6ac0f5b9_en

⁷⁴Përfshirja e 400 fëmijëve romë në procesin e arsimit parashkollor, me qëndrimi pa pagesë në kopshte, 700 bursa për shkollarë romë në vit, normë të lartë të punësimit të romëve në administratën shtetërore dhe publike, mbështetje për banimin, në kuptim të legalizimit të shtëpive të tyre, të gjitha të përmendura si qëllime të realizuara që Ministria së bashku me partnerët ka punuar në periudhën e kaluar.

⁷⁵Përfshirja e romëve në axhendën digjitale është kryesisht përmes rritjes së qasjes në mjetet digjitale, arsimimin digjital, mbështetjen e fëmijëve në fushën e arsimit të romëve, tregun e punës në kuptimin e përvetësimit dhe përdorimit të shkathtësive të duhura, si dhe mbështetjen e sipërmarrësve romë për të digjitalizuar aktivitetet e tyre. Në fushën e axhendës së gjelbër, përfshirjen e romëve në ekonominë cirkulare, transformimin e sistemeve për menaxhimin e llojeve të ndryshme të mbeturinave dhe resurseve të tjera dhe përfshirjen e modeleve novatore të energjisë së ripërtërishe.

⁷⁶Ministria e Punës dhe Politikës Sociale. (v. 2022, 24 shkurt). *Trençevska: Inkluzion i plotë i romëve në shoqëri është detyrim për të cilin punojmë së bashku*. E arritshme në: <https://bit.ly/3r8AMmv>

poromë i kanë çregjistruar fëmijët e tyre dhe i regjistronin në shkolla të tjera. Kjo bëri që prindërit e fëmijëve romë të besonin se cilësia e arsimit që u ofrohet fëmijëve në shkolla me shumicë rome është në rënie. Kështu, GJEDNJ konstatoi trajtim diskriminues dhe u dha kompensim amvisërive të këtyre fëmijëve.⁷⁷

KKKK shpreh keqardhje që mjediset e përziera në shkolla dhe klasa mbeten përjashtim. Duhet të vazhdohet qasja më interkulturore, duke përfshirë edhe përmes trajnimit të mësimitdhënësve dhe nxënësve për kulturat dhe historitë e pakicave të ndryshme dhe përmes sigurimit të kontakteve më të rregullta midis nxënësve me prejardhje të ndryshme etnike.⁷⁸

Përkundër rritjes së moderuar të normave të regjistrimit dhe uljes së frekuentimit të shkollave speciale, fëmijët romë vazhdojnë të kenë rezultate arsimore dukshëm më të ulëta. Autoritetet duhet të zgjidhin me vendosmëri problemin me de facto arsimin e segreguar, duke përmirësuar regjistrimin e fëmijëve romë në institucionet parashkollore, si dhe qasjen e tyre të mëtejshme në arsimin cilësor.

KPMD miratoi mendim kundër një shkolle filllore në Manastir, me ç'rast autoritetet kanë afat prej gjashtë muaj për të zbatuar masa për të zvogëluar ndarjen e fëmijëve romë në shkollë, e cila bëhet përmes praktikave të regjistrimit në shkollë që përbëjnë diskriminim të tërthortë ndaj fëmijëve romë të cilët janë të ndarë në bazë të përkatësisë së tyre etnike, gjë që është në kundërshtim me Ligjin për arsimin fillor. Me fjalë tjera, prindërve të nxënësve që nuk janë romë u është mundësuar të regjistrojnë fëmijët e tyre në shkolla jashtë mjedisit në të cilin jetojnë për shkak të zbatimit selektiv të Ligjit nga shkolla. Kjo do të thoshte që shkolla u bë de facto e ndarë etnikisht, mqë një numri të madh të fëmijëve që nuk janë romë u është lejuar të transferohen në shkolla në zona të tjera, gjë që shtyro KPMD-në t'u rekomandojë drejtorëve të shkollave në këtë zonë të regjistronin vetëm ata fëmijë që administrativisht i përkasin asaj shkolle, derisa Ministrisë së Arsimit iu rekomandua të vendoste kritere më rigorozë për regjistrimin e fëmijëve që janë jashtë rajonit të tyre.⁷⁹

Pjesëtarët e bashkësisë rome duhet të gëzojnë kujdes shëndetësor falas të garantuar me ligj, ndërsa duhet t'i kushtohet vëmendje e veçantë qasjes së romeve deri te shërbimet dhe informacionet për shëndetin reprodutiv. Qasja e kufizuar në shërbimet shëndetësore rezultoi me një rast të parashtruar në CEDAV, ku Komiteti konstatoi diskriminim ndaj dy grave rome në qasjen e tyre në shërbimet e shëndetit seksual dhe reprodutiv.⁸⁰

Ka përfunduar hartëzimi gjeografik i vendbanimeve rome, gjë që ofron pasqyrë të kushteve të jetesës në vendbanimet rome në 14 komuna me popullsinë më të madhe rome. Megjithatë, strehimi për romët mbeti një çështje shqetësuese. Pjesa më e madhe e vendbanimeve rome nuk janë ende të mbuluara me planet urbanistike. Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut raportoi se disa familje rome përballen përsëri me rrezik social. Me fjalë tjera, ata kanë marrë aktvendim nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale për të braktisur qëndrimin e përkohshëm në qendrën e pranimit Vizbegovë, pa bërë plane për integrimin e tyre të mëtejshëm në shoqëri.⁸¹ Qëllimi i akomodimit të romëve nga Kalaja në strehimore të përkohshme në qendrën e pranimit në Vizbegovë ishte që t'u ndihmohet në përfshirjen e tyre në tregun e punës, t'u sigurohet kujdes social dhe shëndetësor, dokumente identifikimi, në mënyrë që fëmijët të mund të përfshihen në sistemin arsimor dhe të arrihet zgjidhje e përhershme për banimin e tyre, me qëllimin përfundimtar për t'i nxjerrë nga varfëria. Shpërngulja e tyre në këtë moment pa ndonjë plan të ndihmës për banim, të paktën për një periudhë të caktuar pas shpërnguljes nga qendra e pranimit, do t'i kthejë menjëherë në varfëri. Përveç kësaj, duke prezantuar raportin vjetor

⁷⁷GJEDNJ. (v. 2022, 13 dhjetor). Rasti *Elmazova dhe të tjera përballë Maqedonisë së Veriut*. E arritshme në: <https://bit.ly/3i92CxS>

⁷⁸Komiteti Këshillimor për Konventën kornizë për mbrojtjen e pakicave kombëtare (v. 2022, 21 shtator). Mendimi i pestë për Maqedoninë e Veriut. E arritshme në: <https://rm.coe.int/5th-op-north-macedonia-en/1680a82967>

⁷⁹RadioMOF. (v. 2022, 17 prill). QEDR: *KPMD urdhëroi SHF "Gjorgji Sugarev" për të ndaluar segregacionin e fëmijëve romë*. E arritshme në: <https://www.radiomof.mk/ERRC-kszd-mu-naredi-na-osnovnoto-uchilishite-gjorgji-sugarev-da-ja-prekine-segregacijata-na-romskite-deca/>

⁸⁰CEDAV. Komunikimi nr. 103/2016.

⁸¹Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut. (v. 2022, 30 mars). Familjet rome *përballen me shpërngulje me forcë nga qendra e pranimit në Vizbeg*. E arritshme në: <https://bit.ly/3r45dKD>

për vitin 2021, Avokati i popullit bëri të ditur se familjet rome, vendbanimet e improvizuara e të cilave u dogjën në nëntor të vitit 2021 në Gostivar, ende janë pa strehim adekuat.⁸² KPMD veproi në bazë të një ankese të parashtruar nga Qendra Evropiane për të Drejtat e Romëve në Bruksel në lidhje me ndarjen në bazë të përkatësisë etnike⁸³ dhe miratoi rekomandim të përgjithshëm⁸⁴ për autoritetet lokale, drejtorët e shkollave, Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës dhe ISHMJ-në. Komiteti për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave (CEDAV) konstatoi kundërvajtje në favor të gjashtë grave të reja rome që u dëbuan nga shtëpitë e tyre pa paralajmërim gjatë shtatzënisë.⁸⁵ Gratë dhe vajzat rome mbeten veçanërisht të rrezikuara, shpesh për shkak të papunësisë.⁸⁶

Më 8 prill, Ditën ndërkombëtare të romëve, filluan aktivitetet e Rrjetit për të drejtat e romëve. Rrjeti synon të ndikojë në mbrojtjen e të drejtave të njeriut të romëve në Evropë, që të forcojë përpjekjet e përfaqësimit të bazuar në të drejtat, të stimulojë debatin për të drejtat e romëve dhe të vazhdojë kontestet gjyqësore për të drejtat e njeriut si vegël për aktivizëm. Anëtarët e tij janë 18 organizata për të drejtat e njeriut nga 15 vende të ndryshme në mënyrë që të bashkojnë aktivistët të cilët janë ose nuk janë romë, të cilët luftojnë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut të romëve në të gjithë Evropën, ndërsa SHMJR është organizata përfaqësuese nga Maqedonia e Veriut.⁸⁷

KPMD dhe Instituti për hulumtim dhe analiza të politikave Romalitiko nënshkruan Memorandum për bashkëpunim me qëllim avancimin, zhvillimin dhe vazhdimin e bashkëpunimit në kuptim të barazisë, avancimit të të drejtave të njeriut dhe eliminimit të të gjitha llojeve të diskriminimit në përputhje me interesat dhe qëllimet e përbashkëta të të dy subjekteve. Për më tepër, dy subjektet ranë dakord të shkëmbejnë periodikisht informacione në lidhje me rastet që lidhen me diskriminimin të drejtuar ndaj bashkësisë etnike rome.⁸⁸

Shoqata "Iniciativa për të drejtat e grave nga Shuto Orizara" informoi se një vajzë e re nga bashkësisë rome u përball me diskriminim të drejtpërdrejtë, ndërseksional në bazë të racës, ngjyrës së lëkurës, kombësisë dhe përkatësisë etnike, për shkak se asaj iu ndalua përdorimi i pishinës në ditë të caktuara. Drejtoria policore Shuto Orizarë reagoi ndaj kësaj me pohimin se ky nuk është diskriminim. Shoqata, së bashku me OJQ HERA, parashtroua peticion drejtuar KPMD-së dhe Avokatit të Popullit.⁸⁹

Qendra Evropiane për të Drejtat e Romëve (QEDR) njoftoi se autoritetet lokale në Komunën e Prilepit kanë marrë urdhëruar të sigurojnë qasje në ujë të pastër në dy vendbanimet rome në Prilep, pas një peticioni të paraqitur nga QEDR, si dhe një vendimi nga KPMD për diskriminimin e drejtpërdrejtë në bazë të racës, ngjyrës së lëkurës, përkatësisë etnike, prejardhjes sociale dhe pronës në fushën e qasjes në mallra dhe shërbime, meqë këto vendbanime rome nuk kanë qenë asnjëherë të lidhura me ujësjellësin kryesor, përkundër faktit që atje kanë jetuar për një kohë të gjatë bashkësitë rome.⁹⁰

⁸²Avokat i Popullit i Republikës së Maqedonisë së Veriut (v. 2022, mars). *Raport vjetor për nivelin e sigurisë, respektimit, avancimit dhe mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut*. E arritshme në:<https://ombudsman.mk/CMS/Upload/NarodenPravobranitel/upload/Godisni%20izvestai/GI-2021/GI-2021.pdf>

⁸³Komisioni për Parandalim dhe Mbrojtje nga Diskriminimi. (v. 2022, 11 shkurt). Miratohet rekomandim i përgjithshëm për desegregiminfëmijëve romë gjatë regjistrimit në shkollat. E arritshme në: <https://bit.ly/3ICD6Kq>

⁸⁴Komisioni për Parandalim dhe Mbrojtje nga Diskriminimi. (v. 2022, 11 shkurt). Mendim. E arritshme në: <https://bit.ly/3NR2hL3>

⁸⁵CEDAV. Komunikata nr. 107/2016.

⁸⁶Komisioni Evropian. (v. 2022, 12 tetor). Raporti 1për Maqedoninë e Veriut për vitin 2022: Komunikatë nga Komisioni drejtuar Parlamentit Evropian, Këshillit, Komitetit Ekonomik dhe Social Evropian dhe Komitetit të rajoneve, Komunikatë për politikën e zgjerimit të BE-së për vitin 2022. E arritshme në: <https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2022-10/North%20Macedonia%20Report%202022.pdf>

⁸⁷Shoqata Maqedonase e Avokatëve të Rinj. (v. 2022, 8 prill). Është lansuar rrjeti i QEDR-së për mbrojtjen e romëve. E arritshme në: <https://bit.ly/3ZzTr9s>

⁸⁸Komisioni për Parandalim dhe Mbrojtje nga Diskriminimi. (v. 2022, 18 prill). Nënshkruhet memorandum bashkëpunimi mes KPMD-së dhe "Romalitiko". E arritshme në: <https://bit.ly/3kMVyYN>

⁸⁹RadioMOF. (v. 2022, 4 korrik). Diskriminimi i denoncuar - "A e keni ditur se romët kanë të drejtë vetëm një ditë në javë të lahen në pishinë?". E arritshme në: <https://www.radiomof.mk/prijavena-diskriminacija-znaevte-li-deka-romite-imaat-pravo-samo-eden-den-vo-nedelata-da-se-kapat-na-bazen/>

⁹⁰RadioMOF. (v. 2022, 25 gusht). Pas diskriminimit të përcaktuar nga KPMD-ja, pushteti vendor në Prilep duhet të sigurojë ujë të pijshëm për vendbanimet rome. E arritshme në: <https://www.radiomof.mk/po-utvrdena-diskriminacija-od-kszd-lokalnata-vlast-vo-prilep-dobi-naredba-da-obezbedi-pitka-voda-za-romskite-naselbi/>

Sipas të dhënave zyrtare të Agjencisë së Punësimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në gjysmën e parë të vitit 2022 kishte gjithsej 11.923 romë të papunë, gjysma e të cilëve ishin gra (6.101). Megjithëse KPMD dhe Avokati i Popullit nuk kanë marrë ankesa nga gratë rome për diskriminim në vendin e punës, ata janë të vetëdijshëm për këtë çështje dhe rekomandojnë që institucionet të veprojnë në mënyrë sistematike me qëllim që të tejkalohet diskriminimi ndaj grave rome. Ata gjithashtu u bëjnë thirrje grave të raportojnë diskriminimin pa frikë se dikush do të zbulojë të dhënat e tyre personale, e madje edhe nëse nuk janë të autorizuar të veprojnë, t'i udhëzojnë gratë tek autoritetet përkatëse që mund të hetojnë rastin.⁹¹

Hulumtimi i titulluar “Qëndrimet dhe përvojat me paragjykimet, distancën dhe barazinë sociale në Maqedoninë e Veriut” i zbatuar nga Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar (MCMS) tregoi se megjithëse shumica e qytetarëve do të dëshironin të kishin fqinjë të përkatësive të ndryshme etnike ose besimeve të ndryshme fetare, ata nuk mendojnë njësoj kur u pyetën nëse do të dëshironin të kishin fqinjë romë. Shumica e të anketuarve në anketën, 52.5%, u përgjigjën se nuk do të pëlqenin situatën e tillë, gjë që tregon se paragjykimet dhe diskriminimi ndaj romëve ekziston ende në shoqërinë maqedonase.⁹²

2.8. Rekomandime

- Qeveria duhet të angazhohet për zbatimin e mirëfilltë të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit dhe Strategjisë "Një shoqëri për të gjithë".
- Duhet të avancohen politikat për kohezionin social dhe shoqëri të integruar të bazuar në respekt dhe besim midis bashkësive të ndryshme.
- Qeveria duhet të veprojë sipas rekomandimeve të Avokatit të Popullit dhe KPMD-së.
- Nevojiten përpjekje për të siguruar zbatimin e Strategjisë së inkluzionit të romëve për vitet 2022-2030 dhe Planit kombëtar të veprimit për mbrojtjen, avancimin dhe përmbushjen e të drejtave të njeriut të grave dhe vajzave rome për vitet 2022-2024.

⁹¹Shoqata Maqedonase e Avokatëve të Rinj. (v. 2022, 20 tetor). Gratë rome endediskriminohen gjatë punësimit. E arritshme në: <https://bit.ly/3Gxs2x9>

⁹²N. Dimova (v. 2022, 15 nëntor). *Tolerancë dhe vlera të qytetarëve. MCMS*. E arritshme në: <https://mcms.mk/images/docs/2022/tolerancija-i-vrednosti-na-graganite.pdf>

Kapitulli 3 – INTOLERANCA

3.1. Gjuha e urrejtjes

3.1.1. Standardet ndërkombëtare

Në pjesën më të madhe, shfaqjet e gjuhës së urrejtjes filluan të rregullohen në nivel ndërkombëtar, pas gjenocidit gjatë Luftës së Dytë Botërore. Mandati i parë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut u rregullua me nenin 55 të Deklaratës Universale të Kombeve të Bashkuara të vitit 1948, e cila shpalli se Kombet e Bashkuara do të promovonin respektimin universal dhe do t'u përmbahen të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, pavarësisht nga prejardhja etnike, raca, gjinia, gjuha ose bindjet fetare. Ky mandat i përgjithshëm u elaborua në disa dokumente:

- Pakti ndërkombëtar për të drejtat civile dhe politike i vitit 1966;
- Konventa ndërkombëtare për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor e vitit 1966;
- Konventa për parandalimin dhe ndëshkimin e veprës penale gjenocid e vitit 1948;
- Konventa për eliminimin e të gjitha formave të intolerancës fetare të vitit 1967.

Dokumente evropiane

Konventa evropiane për të drejtat e njeriut e Këshillit të Evropës e vitit 1950 është dokumenti më referues evropian që garanton lirinë e shprehjes, por parashikon edhe kufizimin që është i domosdoshëm për një shoqëri demokratike.

Me fjalë tjera, në nenin 10 të Konventës Evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut qëndron përcaktimi se çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë për të pasur mendim dhe për të transmetuar informacione dhe ide pa ndërhyrje nga autoritetet publike. Realizimi i këtyre lirive, si dhe detyrave dhe përgjegjësisë që vijnë me to, mund të jenë lëndë e formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose dënimeve siç është përcaktuar me ligj, të cilat janë të domosdoshme në një shoqëri demokratike në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, për të parandaluar çrregullimin dhe krimin, për të mbrojtur shëndetin ose moralin, për të mbrojtur reputacionin ose të drejtat e të tjerëve, për të parandaluar zbulimin e informacioneve të marra në fshehtësi, ose për të ruajtur autoritetin dhe paanshmërinë e gjyqësorit.

Në vitin 1997, Komiteti i ministrave i Këshillit të Evropës, duke marrë parasysh rëndësinë e lirisë së shprehjes, lëshoi disa rekomandime dhe instrumente për qeveritë e vendeve anëtare për të ndërmarrë masa për të luftuar gjuhën e urrejtjes.

- Këshilli i Evropës, Rekomandimi (97) 20 i vitit 1997;
- Komiteti i ministrave, Deklarata për lirinë e debatit politik në mediat e vitit 2004;
- Këshilli i Evropës, Rekomandimi 1805(2007) mbi blasfeminë, ofendimet fetare dhe gjuhën e urrejtjes ndaj të tjerëve bazuar në religjionin e tyre;
- EKRI, Rekomandimi i përgjithshëm i politikave nr.7 për luftimin e racizmit, ksenofobisë, antisemitizmit dhe intolerancës të vitit 2002;
- EKRI, Rekomandimi i përgjithshëm i politikave nr. 15 për luftë kundër gjuhës së urrejtjes të vitit 2015.

Sipas standardeve ndërkombëtare dhe evropiane, shteti duhet të bëjë dallimin ndërmjet, së pari, rasteve më serioze të gjuhës së urrejtjes që duhet të jenë të ndaluara me ligjin penal; së dyti, gjuhës së urrejtjes që është lëndë e së drejtës civile dhe administrative; dhe së fundi, llojeve të shprehjes

ofenduese ose të dëmshme që nuk plotësojnë pragun për të qenë të kufizuara në mënyrë legjitime, por megjithatë kërkojnë përgjigje alternative.

3.1.2. Legjislacioni kombëtar

Kriminalizimi i gjuhës së urrejtjes në Maqedoninë e Veriut

Duke marrë parasysh angazhimet ndërkombëtare kundër gjuhës së urrejtjes dhe rekomandimet e bëra për të luftuar gjuhën e urrejtjes në mënyrë më efikase, Maqedonia e Veriut parashikon kriminalizimin e gjuhës së urrejtjes dhe përmbajtjes së saj në Kodin Penal. Ndalimet penale për gjuhën e urrejtjes përqendrohen në kriminalizimin e keqpërdorimit të lirisë së shprehjes që përbëhet nga shpifja, nxitja e dhunës ose shkeljet e tjera të lirisë dhe të drejtave të barabarta; ose shprehja e qëndrimit diskriminues ndaj të tjerëve. Megjithëse terminologjia e Kodit penal nuk përdor termin "gjuha e urrejtjes", veprat e kriminalizuara përbëjnë gjuhë të urrejtjes dhe ato shtohen për të përmbushur detyrimet ndërkombëtare, në veçanti Rekomandimin e përgjithshëm për politikë nr. 7 të EKRI për të luftuar racizmin, ksenofobinë, antisemitizmin dhe intolerancën.

Rekomandimi i përgjithshëm për politikë nr.7 për legjislacionin kombëtar për të luftuar kundër racizmit dhe diskriminimit racor rekomandon ndryshime në Kodin penal për të luftuar deklaratat të ndryshme raciste në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës. Deklaratat e tilla kanë të bëjnë me nxitjen publike të dhunës, urrejtjes ose diskriminimit, ofendimeve dhe shpifjeve publike ose kërcënimeve ndaj çdo personi ose grupi njerëzish bazuar në racën, ngjyrën e lëkurës, gjuhën, religjionin, shtetësinë ose prejardhjen kombëtare ose etnike. Shprehja publike me qëllim racist ose ideologji raciste ose mohim publik me qëllim racist, krim, gjenocid ose krim kundër njerëzimit ose krim lufte duhet gjithashtu të jetë e dënueshme me ligj. Përhapja publike me qëllim racist ose material që përmban shprehje raciste gjithashtu duhet t'u nënshtrohet sanksioneve penale.

Ndalimet ligjore të gjuhës së urrejtjes kanë për qëllim kriminalizimin e keqpërdorimeve të lirisë së shprehjes që përbëhen nga: nxitja e dhunës ose shkelje të tjera të lirisë dhe të drejtave të barabarta ose shprehje të qëndrimit diskriminues ndaj të tjerëve.

Në rekomandimin nr.15 në lidhje me politikën e përgjithshme, termi "gjuhë e urrejtjes" nënkupton: përfaqësimin, promovimin ose nxitjen, në çdo formë, denigrimin, urrejtjen ose shpifjen e një personi ose grupi personash, si dhe çdo formë ngacmimit, ofendimit, stereotipizimit negativ, stigmatizimit ose kërcënimit në lidhje me një person ose grup personash të tillë dhe justifikimin e të gjitha llojeve të shprehjeve të përmendura më parë bazuar në racën, ngjyrën e lëkurës, prejardhjen, prejardhjen kombëtare ose etnike, moshën, aftësinë e kufizuar, gjuhën, religjionin ose besimin, seksin, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual dhe karakteristikat ose statusin tjetër personal.

Veprat penale në të cilat gjuha e urrejtjes kriminalizohet në Kodin Penal të Republikës së Maqedonisë së Veriut janë: "Rrezikimi i sigurisë" nga neni 144 paragrafi 4, "Shprehja e talljes së popullit maqedonas dhe pjesëtarëve të bashkësive" nga neni 179, "Nxitja e urrejtjes, përçarjes ose intolerancës mbi baza kombëtare, racore, fetare dhe të tjera diskriminuese" nga neni 319, "Përhapja e materialit racist dhe ksenofobik me anë të sistemit kompjuterik" nga neni 394-ç, "Aprovimi ose justifikimi i gjenocidit, krimeve kundër njerëzimit ose krimeve të luftës" nga neni 407-a dhe "Diskriminim racor dhe diskriminim tjetër" nga neni 417 paragrafi 3 nga Kodi Penal.

Në nenet e Kodit Penal, arsyet janë marrë nga Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe i referohen bazës së gjinisë, racës, ngjyrës së lëkurës, gjinisë, përkatësisë së një grupi të marginalizuar, përkatësisë etnike, gjuhës, shtetësisë, origjinës sociale, fesë ose besimit fetar, llojeve të tjera të besimeve, arsimit, përkatësisë politike, statusit personal ose shoqëror, paaftësisë mendore ose fizike, moshës, statusit familjar ose martesor, statusit të pasurisë, statusit shëndetësor. Në nenet "Nxitje të urrejtjes, përçarjes ose intolerancës në baza kombëtare, racore, fetare dhe të tjera diskriminuese" nga neni 319, "Përhapja e materialit racist dhe ksenofobik përmes sistemit kompjuterik"

nga neni 394-ç “Diskriminim racor dhe të tjera” të nenit 417 paragrafi 3 të Kodit Penal, orientimi seksual dhe identiteti gjinor nuk janë përmendur konkretisht si arsye. Për të kuptuar më mirë konceptin e gjuhës së urrejtjes, si dhe përhapjen e gjuhës së urrejtjes të bazuar në orientimin seksual dhe identitetin gjinor, është e nevojshme të shtohen këto baza.

Bazuar në dispozitat e Kodit Penal, mund të konkludohet se korniza formale ligjore për njohjen dhe sanksionimin e gjuhës së urrejtjes është mbizotërues në nene të ndryshme, nuk është mjaft e saktë dhe nuk ofron një kornizë të qartë për përkufizimin dhe fushëveprimin e gjuhës së urrejtjes. Paqartësitë konceptuale hapin rrugën për diskrecionin e tepruar të organeve për zbatimin e ligjit dhe keqpërdorimet potenciale (për shembull, për persekutimin politik të disidentëve ose përgjegjësinë penale për ofendimet që nuk bëjnë pjesë në kuadër të këtij koncepti). Në këtë kuptim, është i nevojshëm përkufizimi i qartë i rrethanave të përshtatshme për shqiptimin e sanksionit penal për një rast konkret të përdorimit të gjuhës së urrejtjes. Paqartësitë konceptuale në lidhje me gjuhën e urrejtjes ndikojnë gjithashtu në zhvillimin e praktikës gjyqësore.

Dënimet e parashikuara në dispozitat e gjuhës së urrejtjes të Kodit Penal të Maqedonisë së Veriut janë gjoba ose dënime me burg nga një deri në pesë vjet, e për veprat e kryera penale në rrethana të vështirësuar, mund të shqiptohet dënim me burgim nga një deri në dhjetë vjet. Megjithatë, paraburgimi dhe dënimet e larta me siguri nuk do të konsiderohen proporcionale sipas nenit 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përveç në raste shumë të rënda të gjuhës së urrejtjes. Përveç kësaj, shteti duhet të krijojë kushtet dhe praktikën e shqiptimit të masës punës së përgjithshme të dobishme sipas nenit 58-b (1) në bazë të urrejtjes ndaj individit ose grupit, e gjithë kjo me qëllim të riintegritimit dhe rehabilitimit të autorëve krahas dënimit me burgim ose gjobë.

Ligji për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi

Ligji i parë për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi u miratua në vitin 2010. Ligji u miratua me disa lëshime thelbësore, siç është fakti se nuk ishin përfshirë segregacioni dhe diskriminimi asociativ, orientimi seksual dhe identiteti gjinor mungonin nga lista e bazave të renditura/karakteristikave të mbrojtura, Ligji nuk u dha mundësi shoqatave që kanë një interes legjitim në luftën kundër racizmit dhe diskriminimit racor (që nënkupton gjithashtu gjuhën e urrejtjes) për të ngritur padi për mbrojtje nga diskriminimi i interesit publik (actiopopularis).

Ligji i ri për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi i vitit 2020 ka fjalor dhe përkufizime të mira, si dhe listë të gjerë dhe të hapur të bazave diskriminuese. Ky ligj njeh orientimin seksual dhe identitetin gjinor si bazë e ndaluar, krahas karakteristikave të tjera mbrojtëse që ishin parashikuar në Ligjin paraprak për mbrojtje nga diskriminimi të vitit 2010. Ligji ekzistues mbron karakteristikat e mëposhtme nga diskriminimi: raca, ngjyra e lëkurës, prejardhja, prejardhja kombëtare ose etnike, gjinia, seksi, orientimi seksual, identiteti gjinor, përkatësia në grup të marginalizuar, gjuha, shtetësia, prejardhja sociale, arsimi, religjioni ose bindja fetare, bindja politike, bindje tjetër, aftësia e kufizuar, moshë, gjendja familjare ose martesore, statusi i pasurisë, gjendja shëndetësore, veçoria personale dhe statusi shoqëror ose çdo bazë tjetër.

Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi i vitit 2020 nuk e njeh shprehimisht gjuhën e urrejtjes si të tillë, por përmban elemente përmes të cilave mund të ndalohet gjuha e urrejtjes. Me fjalë tjera, neni 9 rregullon thirrjen, nxitjen dhe instruksionet për diskriminim, derisa neni 10 e përshkruan ngacmimin si sulm ndaj dinjitetit dhe krijimin e mjedisit të frikshëm. Mandati i Komisionit për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi për përballje me gjuhën e urrejtjes rezultoi nga nenet 9 dhe 10 të Ligjit, por Komisioni nuk ka mandat eksplicit për t'u marrë me gjuhën e urrejtjes dhe për këtë arsye në praktikë mungon strategji konkrete për përballje me rastet e gjuhës së urrejtjes.

Gjuha e urrejtjes si fenomen që synon këto grupe të përfshira nga legjislati për trajtimin e barabartë të karakteristikave mbrojtëse prek në mënyrë të pashmangshme trupat për barazi me mandatet e tyre ligjore për të promovuar barazinë dhe për të luftuar diskriminimin mbi këto baza si në parandalimin ashtu edhe në pjesën për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi. Kështu, sipas standardeve

evropiane, mandati i trupave për barazi duhet të zgjerohet për t'i përfshirë të gjitha segmentet e përballjes me gjuhën e urrejtjes, gjë që do të mundësojë shpërndarjen e resurseve për të luftuar gjuhën e urrejtjes.

Ligji për parandalimin e dhunës dhe sjelljes së pahijshme në garat sportive

Ky ligj rregullon çështjet që kanë të bëjnë me dhunën dhe sjelljen e papërshtatshme në garat sportive, si dhe masat për parandalimin e tyre, garantimin e sigurisë së spektatorëve. Neni 3 përshkruan dhunën dhe sjelljen e pahijshme, ndër të tjera, si hyrjen dhe theksimin e banderolave, flamujve dhe sendeve të tjera me tekst, fotografi, shenja ose simbole të tjera, si dhe këndimin e këngëve ose hedhjen e mesazheve që shkaktojnë dhe nxisin urrejtje ose dhunë në bazë të përkatësisë racore, kombëtare dhe fetare ose në bazë të veçorive të tjera. Gjoha për këtë vepër është nga 180 deri në 220 euro në denarë. Tifozët dhe grupet e tifozëve janë gjeneratorët më të mëdhenj të gjuhës së urrejtjes. Shpeshtësia dhe intensiteti i gjuhës së urrejtjes që ndodh në tribuna ka potencial serioz për të provokuar akte të urrejtjes. Në këtë drejtim, gjobat relativisht të vogla nuk janë të mjaftueshme për të parandaluar këtë dukuri.

Ligji për shërbimet mediatike audio dhe audiovizuale

Ligji për shërbimet mediatike audio dhe audiovizuale u miratua në vitin 2013. Me të ndalohej emetimi i përmbajtjeve mediatike që nxisin diskriminim, intolerancë apo urrejtje. Në versionin origjinal të ligjit, ky ndalim përfshinte vetëm bazat diskriminuese siç janë raca, gjinia, religjioni apo kombësia. Me Ligjin për ndryshime dhe plotësime në Ligjin për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale të 31 dhjetorit të vitit 2018, pa bërë ndryshimet kryesore në drejtim të harmonizimit me standardet evropiane në këtë fushë. Prandaj, Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale tani ndalon emetimin e përmbajtjeve mediatike që nxisin ose përhapin diskriminim, intolerancë ose urrejtje në bazë të racës, ngjyrës së lëkurës, prejardhjes, përkatësisë kombëtare ose etnike, seksit, gjinisë, orientimit seksual, identitetit gjinor, që i përkasin një grupi të marginalizuar, gjuhës, kombësisë, prejardhjes sociale, religjionit ose bindjes fetare, bindjes politike, bindjes tjetër, aftësisë së kufizuar, moshës, statusit familjar ose martesor, statusit të pronës, gjendjes shëndetësor, veçorisë personale ose statusit shoqëror, ose mbi çfarëdo baze tjetër. Për më tepër, shërbimet mediatike të Agjencisë audiovizuale mund të marrin ankesa në lidhje me gjuhën e urrejtjes nga mediat audiovizive, si dhe të veprojnë sipas detyrës zyrtare. Më konkretisht, Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale "mund të ndër marrë masa kur përcakton gjuhën e urrejtjes në përmbajtjen e mediave audiovizuale (neni 48), të tilla si: paralajmërim publik, kërkesë për të filluar procedurë kundërvajtëse, propozim për heqjen e licencës dhe aktvendim për fshirjen e medias nga regjistri (neni 23). Për shkeljen e këtij neni parashikohet gjobë deri në 5.000 euro për personin juridik, ndërsa nuk përjashtohet përgjegjësia penale (neni 147).

Zhvillimi teknik ka ndryshuar shprehitë e shikimit të përmbajtjeve audiovizuale, veçanërisht të rinjtë, ndërsa rrjetet sociale janë bërë mjeti kryesor i shkëmbimit dhe pranimit të informacioneve. Si rrjedhojë, është vërejtur një ndryshim në gjuhën e urrejtjes nga mediat tradicionale në internet, mbi të cilat nuk ka organ rregullator. Me ndryshimet e reja në Ligjin për shërbimet mediatike audio dhe audiovizuale, i cili pritet të miratohet në vitin 2023, me rregullativën do të përfshihen subjektet si YouTube, Dailymotion dhe platforma të tjera; Përmbajtja audiovizuale që ndahet përmes rrjeteve sociale si Facebook, Twitter, TikTok, Instagram, etj.; por edhe pjesë të pavarura të faqeve të internetit të gazetave ose mediave në internet që përmbajnë programe audiovizuale ose video të krijuara nga përdoruesit, nëse plotësojnë kriteret për shërbim mediatik audiovizuel. Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale do të jetë përgjegjëse për platformat për shkëmbimin e videove që janë themeluar ose do të themelohen në vend, si dhe ato që do të plotësojnë kushtet për të qenë në juridiksionin e Maqedonisë së Veriut. Portalet informative dhe faqet e internetit do të vazhdojnë të jenë të parregulluara.

Ballafaqimi me gjuhën e urrejtjes në internet

Në vend nuk ka asnjë organ rregullator për internet, e kjo fushë nuk është në kompetencën e trupit rregullator për mediat audiovizuale. Departamenti i krimit kibernetik dhe forenzikës digjitale në Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB) është organi përgjegjës për ballafaqim me incidente në internet dhe parandalimin e përhapjes së mëtejshme të gjuhës së urrejtjes. Në vitin 2015, Ministria e Punëve të Brendshme vendosi Vijë të kuqe përmes së cilës mund të parashtrihen lehtësisht ankesat ose rastet e gjuhës së urrejtjes në internet.

Në praktikë, agjencitë për zbatimin e ligjit përballen me sfida. Me fjalë tjera, madje edhe në rastet kur Ministrisë së Punëve të Brendshme i është i njohur personi që qëndron pas përhapjes së gjuhës së urrejtjes, ata nuk mund të lidhin identitetin e tij digjital dhe fizik pa bashkëpunim me mediat sociale.

Duke marrë parasysh zhvillimin e zbulimeve të reja teknologjike dhe rritjen e përdorimit të internetit edhe në nivel global edhe në nivel kombëtar, është e domosdoshme që Maqedonia e Veriut të miratojë legjislacion efektiv për të parandaluar dhe luftuar gjuhën e urrejtjes në internet.

3.1.3. Pasqyrë e përgjithshme e situatës me gjuhën e urrejtjes

Ndjekja e situatës me gjuhën e urrejtjes në rrjetet sociale

Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në vitin 2022, ngjashëm si në vitin 2021, regjistroi një numër të lartë të rasteve të gjuhës së urrejtjes në rrjetet sociale, të regjistruara në portalin www.govornaomraza.mk. Gjuha e urrejtjes e bazuar në përkatësinë politike dhe etnike përsëri kryesoi denoncimet, duke arritur në dy të tretat e të gjitha rasteve. Në të njëjtën kohë, denoncimet e bazuara në orientimin seksual dhe identitetin gjinor shënuan rritje dhe mbetën të larta në vitin 2022. Ajo që është shqetësuese si dukuri në vitin 2022 është gjuha e regjistruar e urrejtjes në lidhje me përkatësinë politike, gjë që bën të ditur në ndarjen dhe polarizimin plotësues në shoqërinë.

Për shembull, në vitin 2021, janë regjistruar gjithsej 877 denoncime. Përkatësia etnike përsëri kryesoi denoncimet, duke arritur në 34% të të gjitha rasteve. Orientimi seksual dhe identiteti gjinor përbënin 33% të denoncimeve, një rritje proporcionale me rritjen e dukshmërisë së bashkësisë LGBTI gjatë muajit të krenarisë në qershor. Kjo tendencë është vetëm një vazhdim i retorikës që filloi në vitin 2020.

Me këtë raport, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut konfirmon edhe një herë trendin negativ që filloi në vitin 2019 dhe arriti kulmin në vitin 2020 me fillimin e pandemisë globale të Kovid-19. Përmes monitorimit të vendosur sistematik të mediave sociale, bëhet e evidente se diskursi publik transmetohet në mediat sociale dhe përdoret për manipulim emocional dhe klik bejt pa marrë parasysh pasojat negative të kësaj qasjeje. Raporti përkon me ngjarjet kryesore vendore dhe ndërkombëtare që kontribuuan më tej në intensifikimin e retorikës negative në rrjetet sociale. Përkundër mbështetjes deklarative nga institucionet kompetente, përmes monitorimit në vitin 2022 mund të konstatohet se nuk ka asnjë mekanizëm sistematik dhe gjithëpërfshirës për ballafaqim me këtë dukuri, si dhe sanksionimin e saj.

Numri më i madh i rasteve në vitin 2020 i referohen zgjedhjeve të parakohshme parlamentare (të mbajtura më 15 korrik të vitit 2020) dhe tonit të përgjithshëm negativ politik. Kjo rezultoi me numër të madh të rasteve të denoncuara të gjuhës së urrejtjes në lidhje me përkatësinë politike dhe etnike. Për shkak të ndryshimeve në mënyrën e udhëheqjes së fushatës politike për shkak të pandemisë, shumica e mesazheve nga partitë politike u transmetuan dhe diskutuan në rrjetet sociale. Ndonëse pjesa më e madhe e fushatës u zbatua me mjete virtuale, megjithatë u zhvillua fushatë tradicionale duke organizuar mitingje, ku nuk u respektuan plotësisht masat mbrojtëse (veçanërisht në lidhje me mbajtjen e maskave). Kjo rezultoi me shkëmbimin e gjuhës së urrejtjes në rrjetet sociale, që përveç asaj politike, po ashtu kishin edhe kontekst etnik. Sa për krahasim, nga 1 prilli i vitit 2019 deri në fund të ciklit të dytë të zgjedhjeve parlamentare, Komiteti i Helsinkit regjistroi 63 denoncime të gjuhës së urrejtjes. Gjatë këtyre zgjedhjeve është vërejtur rritje prej mbi 80% në denoncimet për kategoritë e

njëta. Diskursi negativ nga periudha paszgjedhore në korrik vazhdoi edhe në gusht të vitit 2020, me retorikë shumë më të forcuar dhe ofenduese. Bisedimet për qeveri të re prodhuan gjuhë të urrejtjes, kryesisht të lidhura me përkatësinë etnike, që rezultoi nga bisedimet ndërmjet Lidhjes Socialdemokrate të Maqedonisë (LSDM) dhe Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI). Numri më i madh i rasteve janë regjistruar më 25 gusht të vitit 2020, pas paralajmërimit të koalicionit paszgjedhor midis LSDM-së dhe BDI-së.

Nga Raporti vjetor i Ministrisë së Punëve të Brendshme rezulton se gjatë vitit 2021, janë regjistruar gjithsej 25 vepra penale nga fusha e krimeve nga urrejtja, gjë që paraqet rënie prej 13,8% në krahasim me vitin 2020, e pas masave dhe aktiviteteve që janë ndërmarrë në lidhje me inkriminimet e regjistruara, ka pasur 24 kallëzime penale kundër 31 autorëve. Duke parë fushat, numri më i madh, përkatësisht 12 nga veprat penale, u regjistruan në zonën e SPB Ohër, më pas 5 në zonën e SPB Shtip, 3 në zonën e SPB Tetovë, dy në zonën e SPB Manastir, nga 1 në zonën e SPB Shkup, SPB Veles dhe SPB Strumicë. Veprat më të shumta penale janë "përhapja e materialit racist dhe ksenofobik përmes sistemit kompjuterik" – 17 vepra penale, më pas "rrezikimi i sigurisë" – 5 vepra penale, 2 vepra penale për "nxitje të urrejtjes, përçarjes ose intolerancës mbi baza kombëtare, racore, fetare dhe bazë tjetër diskriminuese", si dhe 1 vepër për "diskriminim racor dhe diskriminim tjetër". Kjo tendencë e kryerjes së krimeve përmes sistemit informativ vazhdon, e cila në vitin 2021 është rritur për 8,7% krahasuar me vitin 2020 dhe arrin 88% të numrit të përgjithshëm të veprave të denoncuara. Veprimet janë ushtruar me kërcënime për jetën dhe trupin dhe nxitje të dhunës ndaj të lënduarve, me ç'rast viktimat më shpesh janë bartës të posteve publike (kryeministër, ministra dhe politikanë aktualë, ish-deputetë). Pozicionimi i këtyre i agjencive për zbatimin e ligjit dhe përdorimin e mekanizmave për të mbrojtur politikanët është shqetësues.

Në vitet e kaluara, veçanërisht nga viti 2018, Komiteti i Helsinkit ka parashtruar dhjetëra ankesa kundër personaliteteve publike, gazetarëve, një kandidati për kryetar komune dhe një kreu të partisë politike, për shkak të seriozitetit të gjuhës së urrejtjes dhe rrezikut të veprimeve të urrejtjes gjatë Paradës së Krenarisë, si dhe kundër personave që bëjnë thirrje për dhunë dhe dëshirojnë vdekjen e anëtarëve të bashkësisë LGBTI dhe të aktivistëve. Nga të gjitha këto denoncime që janë dërguar në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Prokurori, asnjë nga denoncimet nuk ka aktakuzë, as nuk ka pasur zgjidhje ligjore.

Baza e të dhënave të gjuhës së urrejtjes

Ministria e Brendshme, përkatësisht agjencitë për zbatimin e ligjit, Prokuroria Publike dhe gjykatat janë kryesisht përgjegjëse për mbledhjen e informacioneve për veprat penale. Të dhënat duhet të përfshijnë numrin e kallëzimeve, numrin e lëndëve të përpunuara dhe lëndëve të përfunduara. Mirëpo, në legjislacionin kombëtar nuk ka dispozitë të saktë dhe të qartë që imponon detyrim ndaj një trupi të caktuar për të mbledhur, evidentuar dhe përpunuar në mënyrë sistematike të dhëna në lidhje me gjuhën e urrejtjes dhe krimet nga urrejtja.

Në Raportin e Komisionit Evropian për Maqedoninë e Veriut për vitin 2019 bëhet e ditur se "mbledhja e të dhënave për gjuhën e urrejtjes nuk është sistematike, derisa rritja e rasteve të krimeve nga urrejtja është evidentuar në bazën e të dhënave të shoqërisë civile", të përcjellur me konkluzionin e njëjtë në raportin e Komisionit Evropian për Maqedoninë e Veriut për vitin 2020, "vazhdon të jetë problem mbledhja josistematike e të dhënave për gjuhën e urrejtjes" me një trend të vazhdueshëm rritës të incidenteve me krime nga urrejtja të regjistruara në bazën e të dhënave të shoqërisë civile në vitin 2019. Madje edhe në vitin 2021, çështja e mungesës së mbledhjes sistematike të të dhënave për gjuhën e urrejtjes mbetet e hapur.

3.1.4. Bashkëpunimi me institucionet

Në fillim të vitit 2019, u themelua rrjeti për luftimin e gjuhës së urrejtjes në media, iniciator dhe koordinatori i të cilit është Këshilli i Etikës në Mediat në Maqedoni (KEMM). Në themelimin e Rrjetit morën pjesë shoqatat profesionale dhe mediatike, vendimmarrësit, trupat shtetërore dhe rregullatore përgjegjëse për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, organizatat e sektorit civil dhe subjektet e tjera mediatike. Ky proces u mbështet nga Misioni i OSBE-së në Shkup. Anëtarët e Rrjetit nënshkruan Deklaratë kundër gjuhës së urrejtjes në media dhe në internet, nënshkrimi i së cilës shënoi fillimin e funksionimit të Rrjetit.

Në nëntor të vitit 2022, përsëri me mbështetjen e Misionit të OSBE-së në Shkup, u mbajt takim me anëtarët e rrjetit për të diskutuar nënshkrimin e Memorandumit të bashkëpunimit në ballafaqimin me gjuhën e urrejtjes në mediat në Republikën e Maqedonisë së Veriut, me qëllim të koordinimit më të mirë të të gjitha palëve të interesuara. Ky Memorandum pritet të nënshkruhet në vitin 2023.

Në periudhën e kaluar, Komiteti i Helsinkit, në bashkëpunim me Akademinë për Gjykatës dhe Prokurorë Publik, zbatoi trajnime për prokurorët publik dhe gjykatësit për gjuhën e urrejtjes, si dhe trajnime me Ministrinë e Punëve të Brendshme. Edhe pse ka bashkëpunim të përgjithshëm midis Komitetit të Helsinkit dhe organeve për zbatimin e ligjit, ende ka mungesë të praktikës që lëviz në drejtim të mbrojtjes së më të dobëtve dhe më të marginalizuarve në shoqëri, siç janë romët dhe personat me orientim të ndryshëm seksual dhe identitet gjinor, personat me aftësi të kufizuara, etj.

Autoritetet duhet të sigurojnë trajnim për Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Prokurorinë Publike, në mënyrë që të kuptojnë më mirë shfaqjen e gjuhës së urrejtjes, si dhe të vendoset praktikë që do të harmonizohet me dokumentet dhe rekomandimet ndërkombëtare.

3.1.5. Rekomandime

Gjuha e urrejtjes është pasojë e paragjytimeve dhe stereotipave të rrënjosura thellë te qytetarët nga njëra anë dhe zhvillimeve të brendshme politike dhe vendimeve politike për të cilat shpesh ka informacion të pamjaftueshëm ose mungesë edukimi të qytetarëve nga ana tjetër, gjë që në mënyrë plotësuese shkakton përshkallëzim të diskursit. Monitorimi i Komitetit të Helsinkit tregon një rritje të gjuhës së urrejtjes çdo vit.

Si shoqëri në të cilën paragjykimet dhe stereotipat janë të rrënjosura thellë, rekomandimet për përmirësimin e gjendjes janë si vijon:

- Të bëhen ndryshime në Kodin Penal dhe të vendosin orientimin seksual dhe identitetin gjinor si karakteristika të mbrojtura në të gjitha veprat që lidhen me gjuhën e urrejtjes.
- Janë përkufizuar qartë se në cilat marrëdhënie një vepër e caktuar është objekt i ndjekjes penale.
- Lidhur me ndëshkimin, gjykatat duhet të krijojnë kushte dhe të vendosin praktikën e shqiptimit të masës së punës së përgjithshme të dobishme në bazë të urrejtjes ndaj individit ose grupit, me qëllim të riintegritit dhe rehabilitimit të autorëve krahas dënimit me burg ose gjobës.
- Komisionit për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi, si trup për barazi, duhet t'i jepet mandat i qartë për ballafaqim me gjuhën e urrejtjes.
- Të rriten dënimet në Ligjin për parandalimin e dhunës dhe sjelljes së pahijshme në garat sportive me qëllim të trajtimit të gjuhës së urrejtjes në garat sportive.
- Të vendoset një sistem dhe legjislacion efektiv për mbrojtje nga gjuha e urrejtjes në internet.
- Autoritetet duhet të sigurojnë trajnim për Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Prokurorinë Publike, në mënyrë që të kuptojnë më mirë shfaqjen e gjuhës së urrejtjes, si dhe të vendoset praktikë që do të harmonizohet me dokumentet dhe rekomandimet ndërkombëtare.

- Nevojitet rol proaktiv i Ministrisë së Brendshme në monitorimin e gjuhës së urrejtjes në rrjetet sociale, si dhe reagim i shpejtë ndaj njoftimit për veprat e tilla.
- Të specifikohet një detyrim në legjislacionin kombëtar që kërkon një trup i caktuar të mbledhë, evidentojë dhe përpunojë në mënyrë sistematike të dhënat në lidhje me gjuhën e urrejtjes dhe krimet nga urrejtja.

3.2. Krimet nga urrejtja

3.2.1. Standardet ndërkombëtare

Rëndësia e evidentimit dhe ballafaqimit me problemin me krimet nga urrejtja u dallua që në vitin 1965 me miratimin e Konventës ndërkombëtare për eliminimin e diskriminimit racor, derisa miratimi i termit "krim nga urrejtja", i cili vendosë karakteristika të tjera themelore në mbrojtje dhe detyrime specifike, është miratuar shumë më vonë nga bashkësia ndërkombëtare. Vazhdimisht zhvillohej një kornizë gjithnjë e më gjithëpërfshirëse – por kryesisht e paligjshme e detyrueshme – e normave, standardeve, udhëzimeve dhe aktiviteteve për denoncimin, evidentimin dhe mbledhjen e të dhënave për krimet nga urrejtja në Evropë dhe më gjerë. Gradualisht, vetëdija më e mirë për problemin dhe harmonizimi më i ngushtë konceptual dhe praktik midis organizatave dhe agjencive kryesore ndërkombëtare (OAN) aktive në këtë fushë çoi në aktivitete dhe rezultate praktike, udhëzime dhe programe të zbatueshme ndërkombëtarisht për trajnimin dhe ndërtimin e kapaciteteve kombëtare. Ekzistojnë një varg standardesh, disa prej të cilave janë ligjërish të detyrueshme, dhe disa janë "standarde të buta", siç janë rekomandimet e politikave dhe angazhimet politike. Pjesa e radhës ofron një pasqyrë të standardeve më relevante ndërkombëtare që rregullojnë këtë fushë.

Standardet juridike

- *Konventa ndërkombëtare për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor*⁹³ – neni 4(a)
- Pakti ndërkombëtar për të drejtat civile dhe politike¹ – neni 20(2); neni 26
- *Konventa evropiane për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut*⁹⁴
- *Konventa për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje*⁹⁵
- *Vendimi kornizë i Këshillit të Bashkimit Evropian 2008/913/JNA për luftimin e formave të caktuara të racizmit dhe ksenofobisë*⁹⁶
- *Direktiva 2012/29/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit Evropian*⁹⁷
- *Aktvendimet kryesore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut*⁹⁸ – Identoba dhe të tjerët kundër Gjeorgjisë⁹⁹, Seçiç kundër Kroacisë¹⁰⁰, Angellova dhe Iliev kundër Bullgarisë¹⁰¹, Sabaliç kundër Kroacisë¹⁰²

⁹³Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara (v. 1965).

⁹⁴Këshilli i Evropës (v. 1953).

⁹⁵Këshilli i Evropës (v. 2014).

⁹⁶Këshilli i Bashkimit Evropian (v. 2008).

⁹⁷Parlamenti Evropian dhe Këshilli i Bashkimit Evropian (v. 2012).

⁹⁸Aktgjykimet kryesore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në fushën e krimeve nga urrejtja (në lidhje me disa raste të dhunës raciste, dhunës homofobike, dhunës fetare dhe deri diku aftësisë së kufizuar), shqyrtojnë të drejtën e viktimave për të qenë të lirë nga tortura dhe trajtimi çnjerëzor dhe degradues dhe të drejtën e tyre për jetë. Gjykata mori në pyetje dhe hetoi veprimet e policisë dhe hetimit policor në rastet e krimeve nga urrejtja dhe ua imponoi detyrimin ndaj autoriteteve kombëtare për të zbuluar motivin e paragjykimit përmes hetimit efektiv dhe me kohë.

⁹⁹Kallëzimi nr. 73235/12 nga 12 maji i v. 2015

¹⁰⁰Kallëzimi nr. 40116/02 më 31. maj të v. 2007.

¹⁰¹Kallëzimi nr. 55523/00, më 26. korrik të v. 2007.

¹⁰²Kallëzimi nr. 50231/13 më 14 janar të v. 2021.

Shiko më shumë në L Lazarova Trajkovska, M. Zhesko, M. (v. 2021). *Analiza e praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në lidhje me gjuhën e urrejtjes dhe krimin nga urrejtja*. OSBE. Në dispozicion

Maqedonia e Veriut është shtet anëtar i Konventës ndërkombëtare për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor (KNEGJFDR) dhe i Paktit ndërkombëtar për të drejtat civile dhe politike (PNDCP), me ratifikimin e vitit 1994.¹⁰³ Vendi bëri¹⁰⁴ një deklaratë në KNEGJFDR, në të cilën bën të ditur se "Republika e Maqedonisë deklaroi se një kompetencën e Komitetit për eliminimin e diskriminimit racor për të pranuar dhe shqyrtuar komunikime nga individë ose grupe individësh brenda kompetencës së saj, të cilët pretendojnë se janë viktime të shkeljes nga Republika e Maqedonisë të çfarëdo të drejte të saj të përmendur në këtë Konventë, me rezervën se Komiteti nuk do të marrë në konsideratë asnjë komunikim nga individë ose grupe individësh, përveç nëse përcaktohet se e njëjta çështje nuk ka qenë dhe nuk po shqyrtohet në një procedurë tjetër të hetimit ose marrëveshjes ndërkombëtare."¹⁰⁵ Republika e Maqedonisë së Veriut është vend anëtar i Konventës së KB-ve për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, të cilën e ratifikoi më 29 dhjetor të vitit 2011. Maqedonia e¹⁰⁶ Veriut ratifikoi Konventën e Këshillit të Evropës (KiE) për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore më 10 prill të vitit 1997. Vendi ratifikoi Konventën e KE-së për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje më 23 mars të vitit 2018, ndërsa Konventa hyri në fuqi më 1 korrik të vitit 2018¹⁰⁷, me disa rezerva.¹⁰⁸ Duke marrë parasysh konkluzionin e marsit të vitit 2020 të Këshillit të Bashkimit Evropian për hapjen e negociatave aderuese me Republikën e Maqedonisë së Veriut, vendi është zotuar të harmonizojë legjislacionin e tij me të drejtën e BE-së, duke përfshirë edhe Vendimin kornizë 2008/913/JNA për luftimin e formave të caktuara të racizmit dhe ksenofobisë dhe Direktivën 2012/29/BE. Aktgjykimet e miratuara nga Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut janë juridikisht të detyrueshme për vendet në fjalë. Mirëpo, aktgjykimet dhe vendimet e Gjykatës shërbejnë për të sqaruar, mbrojtur dhe avancuar rregullat e përcaktuara me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, krahas vendimmarrjes për rastet konkrete që janë prezantuar para saj. Kjo ndihmon vendet të mbështesin detyrimet që kanë marrë përsipër si palë të larta kontraktuese. Prandaj, qëllimi i sistemit të vendosur nga Konventa është të përcaktojë, në interesin e përgjithshëm, çështjet e politikës publike, ngritjen e kufirit për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe shtrirjen e jurisprudencës së të drejtave të njeriut në të gjithë vendet e Konventës.¹⁰⁹

Dispozitat politike

- *Vendim i Këshillit të ministrave të OSBE-së nr. 12/04*¹¹⁰
- *Vendim i Këshillit të ministrave të OSBE-së nr. 9/09*¹¹¹
- *Rekomandimi i përgjithshëm për politika të EKRI nr.1 për luftë kundër racizmit, ksenofobisë, antisemitizmit dhe intolerancës*¹¹²

në<https://www.osce.org/files/f/documents/2/c/524601.pdf>.

¹⁰³Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara. *Statusi i ratifikimit TABELA INTERAKTIVE*. Në dispozicion në<https://indicators.ohchr.org/>.

¹⁰⁴Ndonjëherë vendet bëjnë "deklarata" në lidhje me të kuptuarit e tyre të një çështjeje ose interpretimin e një dispozite të caktuar. Ndryshe nga rezervat, deklaratat vetëm sqarojnë pozicionin e vendit dhe supozohet se përjashtojnë ose modifikojnë efektin juridik të marrëveshjes. Zakonisht, deklaratat bëhen në momentin e deponimit të instrumentit përkatës ose në momentin e shkrimit.

¹⁰⁵Deklaratë e dhënë më 22 dhjetor të v. 1999

¹⁰⁶OHCHR. *Statusi i ratifikimit TABELA INTERAKTIVE*. E arritshme në<https://indicators.ohchr.org/>.

¹⁰⁷Këshilli i Evropës *Grafiku i nënshkrimeve dhe ratifikimeve të Marrëveshjes nr. 210*. E arritshme në<https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list?module=signatures-by-treaty&treatynum=210>.

¹⁰⁸Këshilli i Evropës *Rezervimet dhe deklaratimet për Marrëveshjen nr. 210*. Në dispozicion në<https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list?module=declarations-by-treaty&numSte=210&codeNature=2&codePays=TFY>.

¹⁰⁹Këshilli i Evropës kundër Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. (v. 2022, 31 gusht). *Doracak për nenin 46 të Konventës – Forca detyruese dhe ekzekutimi i aktgjyimeve*. E arritshme nëhttps://www.echr.coe.int/Documents/Guide_Art_46_ENG.pdf.

¹¹⁰Këshilli ministror i OSBE-së (v. 2004, 7 dhjetor).

¹¹¹Këshilli Ministror i OSBE-së (v. 2009).

¹¹²Komisioni Evropian kundër racizmit dhe intolerancës (EKRI) (1996).

- *Rekomandimi i përgjithshëm për politika të EKRI nr. 11 për luftën kundër racizmit dhe diskriminimit racor gjatë ushtrimit të detyrave policore*¹¹³
- *Rekomandimet nr. 2*¹¹⁴, *5*¹¹⁵, *7*¹¹⁶ *dhe 15*¹¹⁷ *të EKRI.*

Këshilli i ministrave përbëhet nga ministrat e jashtëm të shteteve pjesëmarrëse të OSBE-së dhe është organi qendror vendimmarrës dhe drejtues i Organizatës, vendimet e OSBE-së miratohen me konsensus nga vendet pjesëmarrëse dhe reflektojnë qëndrimet e tyre të dakorduara.¹¹⁸ Ato janë politikisht të detyrueshme për Republikën e Maqedonisë së Veriut si shtet pjesëmarrës në OSBE.¹¹⁹ Deklarimet, deklaratat, raportet, letrat ose llojet e tjera të dokumenteve të miratuara nga trupi vendimmarrës i OSBE-së konsiderohen si dokumente zyrtare të OSBE-së.

Komisioni Evropian kundër racizmit dhe intolerancës (EKRI) ka elaboruar rekomandime të përgjithshme të politikave (RPP) drejtuar qeverive të të gjitha vendeve anëtare të Këshillit të Evropës, duke përfshirë edhe Republikën e Maqedonisë së Veriut. Ato sigurojnë udhëzime të hollësishme që kreatorët e politikave janë të ftuar t'ç'i përdorin gjatë hartimit të strategjive dhe politikave kombëtare në fusha të ndryshme.

3.2.2. Legjislacioni kombëtar

Kodi Penal i Maqedonisë u miratua në vitin 1996, u ndryshua në shtator të vitit 2009¹²⁰ dhe më pas në dhjetor të vitit 2018, veçanërisht në fushën e krimeve nga urrejtja. Ndryshimet e miratuara reflektojnë shumë standarde ndërkombëtare dhe praktika të mira në fushën e legjislacionit për krimet e motivuara nga paragjykimi dhe përfaqësojnë përmirësim të madh të kornizës së mëparshme ligjore për ndëshkimin e veprave të tilla penale në Maqedoninë e Veriut.

Nevoja për "të kundërshtuar paragjykimin e pranishme ndaj grupeve të caktuara dhe për të kompensuar dëmin që ua shkakton viktimave, anëtarëve të tjerë të grupit të njëjtë dhe shoqërisë në tërësi" arsyeton dënimin e krimeve që janë të paktën pjesërisht të motivuara nga njëanshmëria më rreptësisht sesa krimet e kryera pa motivim të tillë. Kërcënimet potenciale për rendin dhe sigurinë publike që rrjedhin nga konfliktet midis grupeve të ndryshme, të cilat mund të shkaktojnë trazira ndëretnike ose sociale, janë edhe një aspekt i dëmtimit të mundshëm të shoqërisë në tërësi. Në këtë kuptim, krimet nga urrejtja janë "krime me një porosi", përmes të cilës autori i krimit përcjell një mesazh se anëtarët e grupit të viktimës nuk janë të dëshirueshëm dhe nuk përshtaten në shoqëri, jo vetëm viktimës konkrete, por edhe anëtarëve të tjerë të grupit të viktimës (të perceptuar ose real) dhe shoqërisë në tërësi.¹²¹ Është e nevojshme që autori të zgjedhë viktimat e tij bazuar në një karakteristikë të përbashkët - të quajtur "karakteristika të mbrojtura" në kontekstin e legjislacionit për "krime nga urrejtja" - në mënyrë që të ketë një qëllim të njëanshëm. Këto veçori, të tilla si kombësia, prejardhja kombëtare ose etnike, ngjyra e lëkurës, gjuha, religjioni ose bindjet fetare, orientimi seksual, identiteti gjinor ose aftësia e kufizuar, janë ose të pandryshueshme ose në mënyrë tjetër themelore për identitetin e një individi.¹²² Koncepti i krimit të motivuar nga njëanshmëria kërkon vepër themelore penale, një veprim që në vetvete është ose i ndaluar dhe i sanksionuar nga ligji penal.

¹¹³Komisioni Evropian kundër racizmit dhe intolerancës (EKRI) (2007).

¹¹⁴ EKRI - miratuar më 13 qershor të v. 1997 dhe rishikuar më 7 dhjetor të v. 2017

¹¹⁵EKRI (v. 2000).

¹¹⁶EKRI (v.2002)

¹¹⁷EKRI (v. 2015).

¹¹⁸Proceset vendimmarrëse të organeve negociuese të OSBE-së rregullohen me Rregulloren e punës. OSBE (v. 2006, 1 nëntor) Rregullorja e punës. E arritshme në <https://www.osce.org/files/f/documents/5/0/22775.pdf>.

¹¹⁹Shihni listën e plotë të vendeve pjesëmarrëse. *Vendet pjesëmarrëse*. E arritshme në <https://www.osce.org/participating-states>.

¹²⁰Kodi Penal ("Gazeta Zyrtare e Maqedonisë" nr. 114/09) miratuar në shtator të v. 2009, i ndryshuar në dhjetor të v. 2018.

¹²¹OSBE/ODIHR (v. 2009). *Ligjet e krimeve nga urrejtja: Një udhëzues praktik*. i Arritshëm në <https://www.osce.org/files/f/documents/3/e/36426.pdf>.

¹²²Ibid.

Kodi Penal përfshin një dispozitë të përgjithshme në nenin 39(5) që obligon gjykatat të marrin parasysh motive të caktuara të njëanshmërisë gjatë diskutimit për shqiptimin e dënimit. Për momentin, dispozita në nenin 39(6) kërkon që gjykatat të evidentojnë arsyet e moszbatimit të dispozitave për rritjen e dënimit në rastet e krimeve të motivuara nga njëanshmëria. Megjithatë, kjo dispozitë duhet të forcohet duke përcaktuar se gjykatat do të jenë të obliguara të evidentojnë arsyet edhe kur i zbatojnë dispozitat për rritjen e dënimit në rastet e krimeve të motivuara nga njëanshmëria. Kjo do t'i bënte krimet e motivuara nga paragjykimi më të dukshme në gjyqësor dhe do të informonte organet hetimore për krimet e motivuara nga njëanshmëria në të kaluarën. Kjo mund të përdoret për të treguar se motivimi i njëanshmërisë është marrë parasysh, si dhe opinionit më të gjerë, se gjykatat kanë një politikë të tolerancës zero për krimet që janë të motivuara nga paragjykimi në shoqëri.

Neni 39 [Rrethanat vështirësuese]

(5) Gjatë matjes së dënimit, gjykata do të marrë parasysh në veçanti nëse vepra penale është kryer kundër një personi ose grupi personash ose pasurie, drejtpërdrejt ose tërthorazi, për shkak të gjinisë, racës, ngjyrës së lëkurës, klasës, përkatësisë së një grupi të marginalizuar, përkatësisë etnike, gjuhës, shtetësisë, prejardhjes shoqërore, religjionit ose bindjes fetare, llojeve të tjera të bindjeve, arsimit, përkatësisë politike, statusit personal ose shoqëror, paaftësisë mendore ose fizike, moshës, statusit familjar ose martesor, statusit të pasurisë, gjendjes shëndetësore, ose mbi çdo bazë tjetër të parashikuar me ligj ose me marrëveshje të ratifikuar ndërkombëtare.

(6) Nëse gjykata nuk zbaton dispozitën e pikës (5) të këtij neni, ajo është e detyruar të arsyetojë arsyet për një vendim të tillë.

Në nenin 122 i Kodit Penal është vendosur paragraf i ri, me të cilin vepra penale nga urrejtja përkufizohet si vepër penale kundër një personi fizik ose juridik dhe personave ose pasurisë që lidhen me të, që është kryer tërësisht ose pjesërisht për shkak të karakteristikës faktike ose të supozuar të një personi në lidhje me racën, ngjyrën e lëkurës, kombësinë, prejardhjen etnike, religjionin ose bindjet fetare, paaftësinë mendore ose fizike, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, përkatësinë politike. Ky përkufizim njihet me të drejtë konceptin e motiveve të përziera që mbulojnë veprime që kryhen vetëm pjesërisht me motivacion të njëanshmërisë. Veprat me "motive të përziera" konsiderohen "krime nga urrejtja" për sa kohë që motivimi i paragjykimit është një nga motivet për veprën.¹²³ Duke marrë parasysh se vepra penale duhet të klasifikohet si vepër penale e motivuar nga njëanshmëria kur autori supozon gabimisht se viktimi i përket një grupi të caktuar të mbrojtur, përfshirja e elementit karakteristik "e supozuar" forcon përkufizimin e krimit nga urrejtja.

Neni 122 [Përkufizimi i krimit nga urrejtja]

(42) Krimi nga urrejtja, siç përcaktohet nga dispozitat e këtij Ligji, është vepër penale kundër një personi fizik ose juridik dhe personave ose pasurisë së lidhur me të, që kryhet tërësisht ose pjesërisht për shkak të karakteristikës faktike ose të supozuar të një personi në lidhje me racën, ngjyrën e lëkurës, shtetësinë, prejardhjen etnike, religjionin ose bindjet fetare, paaftësinë mendore ose fizike, seksin, identitetin gjinor, orientimin seksual, përkatësinë politike.

Karakteristikat e mbrojtura nga legjislati duhet të plotësojnë tre kritere: karakteristikat të jenë të dukshme nga jashtë, qoftë nga pamja e personit ose nga rrethanat kontekstuale; të jenë të pandryshueshme ose themelore për personin dhe, të jenë shënjeshtë të identitetit të grupit, duke e vendosur individin në një kontekst më të gjerë grupor me identitet të përbashkët grupor.¹²⁴ Lista e karakteristikave të mbrojtura të përcaktuara në nenin 122(42) mbulon shumicën e atyre grupeve që më shpesh janë të targetuara dhe është dukshëm më e avancuar se lista në nenin 39(5), e cila përfshin disa karakteristika që nuk janë të pandryshueshme ose shënjeshtë të identitetit grupor.

¹²³OSBE/ODIHR (v. 2009). Ligjet e krimeve nga urrejtja: Udhëzues praktik.

¹²⁴Ibid.

Përveç kësaj, fushëveprimi kaq i gjerë karakteristikash të mbrojtura është shqetësues, pasi mund, megjithëse pa dashje, të dobësojë konceptin. Arsyeimi prapa kësaj është se krimet e motivuara nga njëanshmëria janë krime me mesazhe dhe sanksionimi i tyre në legjislacionin penal nënkupton se sistemet e drejtësisë penale dhe shoqëritë të cilave u përkasin nuk do të tolerojnë krimet e kryera kundër dikujt thjesht sepse ky person ishte anëtar i një grupi të veçantë ose i lidhur me atë grup. Ky mesazh mund të jetë humbur kur numri i grupeve të mbrojtura është shumë i madh dhe kur kuptimi i asaj që përbën një grup është shumë i gjerë. Për shembull, megjithëse përkatësia politike nganjëherë përfshihet si karakteristikë e mbrojtur në legjislacionin për krimet nga urrejtja, ajo nuk është e pandryshueshme dhe as karakteristikë themelore dhe shpesh mund të ndryshojë me kalimin e kohës. Në këtë drejtim, Zyra e OSBE-së për institucione demokratike dhe të drejtat e njeriut, kur komentoi draft-amendamentet në Kodin Penal në vitin 2016, rekomandoi që përkatësia politike të hiqet si karakteristikë e mbrojtur. Përveç kësaj, ishte e dyshimtë për OSBE/ODIHR nëse vetëm mosha është me të vërtetë një shënjesë i identitetit grupor, pasi përfshirja e kësaj karakteristike mund të paraqesë vështirësi të veçanta kur bëhet dallimi midis një krimi thjesht oportunist dhe një krimi nga urrejtja.¹²⁵ ODIHR rekomandon shmangien e listave të paqarta dhe të hapura të karakteristikave të mbrojtura si “përkatësia në grup të marginalizuar”, pasi këto mund të jenë në kundërshtim me parimin themelor të ligjshmërisë.¹²⁶

Shumica e krimeve themelore që aktualisht përfshihen nga Kodi Penal janë ato që zakonisht i nënshtrohen rritjeve të veçanta të dënimeve me qëllim të luftohen krimet e motivuara nga njëanshmëria. Lista përfshin vrasje (neni 123), dëmtim trupor (neni 130), dëmtim të rëndë trupor (neni 131), detyrim (neni 139), privim të paligjshëm të lirisë (neni 140), torturë dhe veprim dhe dënimin tjetër mizor, çnjerëzor ose degradues (neni 142), rrezikim të sigurisë (neni 144), parandalimin ose prishje të tubimit publik (neni 155), përdhunim (neni 186), sulm seksual ndaj një personi të pafuqishëm (neni 187), përdorim të forcës, ngacmim, rrezikim të sigurisë, dëmtim të pasurisë për shkakimin e urrejtjes, përçarjes ose intolerancës (neni 319). Megjithatë, kjo mund të forcohet me sigurimin e rritjeve specifike të dënimeve për krime të mëtejshme pronësore, të tilla si zjarrvënie, vjedhje, vjedhje e madhe, grabitje me armë ose vjedhje grabitëse.

3.2.3. Pasqyrë e përgjithshme e situatës me krimet nga urrejtja

Në vitin 2022, KMH regjistroi¹²⁷ gjithsej 160 krime/incidente nga urrejtja, menjëherë pas raportimit të tyre nga media ose Ministria e Punëve të Brendshme në buletinet e tyre ditore. 26 nga gjithsej incidentet e regjistruara kishin tregues të qartë të paragjyimit, ndërsa pjesa tjetër ishin incidente të mundshme me tregues të paqartë të paragjyimit, prandaj Komiteti i Helsinkit nuk ishte në gjendje të konfirmonte motivimin për paragjykim në ato raste. Incidentet e mundshme përfshihen në këtë raport për shkak të shfaqjes së treguesve të paragjyimit, duke përfshirë: perceptimin e viktimës/dëshmitarit; komentet e bëra në vend; dallimi midis viktimës dhe autorit në baza etnike; modeli/shpeshësia e incidenteve të mëparshme; natyra e dhunës; mungesa e motiveve të tjera; dhe vendndodhja dhe koha. Incidentet e mundshme përfshihen në këtë raport për shkak të shfaqjes së treguesve të paragjyimit,

¹²⁵OSBE/ODIHR. (v.2016, 14 prill). Komente për draft-ndryshimet e dispozitave të caktuara të Kodit penal të ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë në lidhje me veprat penale të motivuara nga paragjykim. E arritshme në <https://www.osce.org/odihr/313271>.

¹²⁶Ibid.

¹²⁷KMH ndjekë dhe mbledhë të dhëna për krimet nga urrejtja dhe incidentet e motivuara nga urrejtja përmes punës së tyre të përditshme, të denoncuara drejtpërdrejt nga viktimat. MHK gjithashtu ka ndjekur dhe buletinet që i publikon Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) në nivel mujor. MHK bashkëpunon me rrjetet kombëtare - Rrjetin për mbrojtje nga diskriminimi dhe rrjetin kombëtar kundër homofobisë dhe transfobisë (RKHT), me çka zgjerohet fushëveprimi i monitorimit, si dhe qasja tek viktimat potenciale të krimeve dhe incidenteve nga urrejtja. MHK-ja ndjek vazhdimisht një numër të madh gazetash të përditshme me përkatësi të ndryshme ideologjike dhe politike. Monitorimi i mediave elektronike bëhet çdo ditë, përmes dy gjeneratorëve më të njohur të lajmeve onlajn (www.time.mk dhe www.grid.mk), si dhe duke përdorur opsionet e avancuara të kërkimit në pjesën "Lajme" të www.google.com.







duke përfshirë: perceptimin e viktimës/dëshmitarit; viktimat, autorët, statusi i rastit, reagimi nga autoritetet dhe ndikimi në viktimën(et) dhe bashkësinë.

Komiteti këshillimor për Konventën kornizë për mbrojtjen e pakicave kombëtare vëren se policia evidenton midis 29 dhe 51 raste të krimeve të supozuara të urrejtjes në vit, shumë prej tyre me një motivacion racist ose ksenofobik për paragjykim, ndërsa organizatat e shoqërisë civile regjistrojnë një numër edhe më të lartë të krimeve të supozuara nga urrejtja (midis 70 dhe 144 në vit).¹²⁸ Të dhënat e OSBE/ODIHR për krimet nga urrejtja tregojnë se policia raportoi 22 raste në vitin 2021 dhe Prokuroria Publike ndoqi penalisht 125 raste.¹²⁹ Vendi nuk iu përgjigj mospërputhjes së numrit të rasteve të regjistruara nga policia dhe rastet e ndjekura penalisht, dhe informacioni i detajuar nuk ishte i disponueshëm as për OSBE/ODIHR dhe as për opinionin. Kjo është një çështje shqetësuese sepse nuk ka sistem të integruar në dispozicion për mbledhjen e të dhënave që do të bënte të mundur vlerësimin e tendencave në rastet e krimeve nga urrejtja dhe mënyrën se si organet kompetente i kanë zgjidhur ato. Si rrjedhojë, Komiteti Këshillimor rekomandoi që autoritetet të sigurojnë identifikimin e shpejtë, evidentimin dhe hetimin efektiv të incidenteve të krimeve nga urrejtja dhe që përgjegjësit të sillen para drejtësisë.¹³⁰ Megjithatë, në raportin vjetor të Ministrisë për vitin 2022 vërehet përparim në luftën kundër gjuhës së urrejtjes dhe kimit nga urrejtja në përgjithësi, kështu që gjithsej 54 krime me "elemente të urrejtjes" u regjistruan në vitin 2022. Pas masave dhe aktiviteteve të ndërmarra janë zgjidhur 50 vepra penale, për të cilat janë ngritur 48 kallëzime penale kundër 51 autorëve.¹³¹

Karakteristikat e viktimave

Incidentet që kanë ndodhur në bazë të përkatësisë etnike (134 incidente) ende janë më të përfaqësuara me 83.75% të numrit të përgjithshëm të incidenteve të regjistruara në vitin 2022. Për më tepër, 7 krime nga urrejtja kanë qenë të orientuara drejt migrantëve ose refugjatëve për shkak të statusit të tyre, 6 incidente kanë qenë të motivuara nga përkatësia politike dhe bindjet politike; 2 incidente kanë ndodhur për shkak të bindjeve fetare, 2 incidente kanë qenë të motivuara nga orientimi seksual dhe 9 incidente kanë ndodhur për shkak të karakteristikave të tjera të mbrojtura.

Të dhënat e mbledhura nga platforma e internetit www.zlostorstvaodomraza.com tregojnë informacionet e mëposhtme në lidhje me rastet me tregues të qartë të paragjykimit:

	Incidentet për shkak të përkatësia etnike, shtetësisë ose gjuhës.....	134
	Incidente për shkak të përkatësisë politike ose bindjeve politike	6
	Incidente për shkak të statusit të emigrantit/refugjatit	7
	Incidente për shkak të bindjeve fetare.....	2
	Orientimi seksual	2
	Tjetër	9

¹²⁸Sekretariati i Konventës kornizë për mbrojtjen e pakicave kombëtare/Këshilli i Evropës (v. 2022, 21 shtator). *Mendimi i pestë për Maqedoninë e Veriut*. E arritshme në<https://rm.coe.int/5th-op-north-macedonia-en/1680a82967>.

¹²⁹OSBE/ODIHR. *Raportimi për krime nga urrejtja – Maqedonia e Veriut*. E arritshme në<https://hatecrime.osce.org/north-macedonia>.

¹³⁰Sekretariati i Konventës kornizë për mbrojtjen e pakicave kombëtare/Këshilli i Evropës (v. 2022, 21 shtator). *Mendimi i pestë për Maqedoninë e Veriut*.


¹³¹Raporti vjetor i Ministrisë së Punëve të Brendshme për vitin 2022, faq. 45-46. E arritshme në:

https://mvr.gov.mk/Upload/Editor_Upload/Godisen%20izvestaj/%D0%93% D0% BE% D0%B4%D0%B8%D1%88%D0%B5%BD%20%D0%B8% D0% B7%D0%B2%D0%B5%D1%88%D1%82% D0% B1% D1%98_2022_%9C%D0% D0%92%D0%A0.pdf

Llojet e incidenteve


Sipas të dhënave të KMH-së, pjesën më të madhe të incidenteve i kanë kryer të rinjtë, ndërsa ka edhe numër të madh të autorëve të panjohur. Viktimat dhe autorët janë zakonisht pjesëtarë të bashkësive të ndryshme etnike, derisa incidentet e denoncuar janë të lidhura me krimet e përcaktuara në Kodin Penal. Shumica e veprave të përmendura penale përfshijnë: dhunë (116), dëmtime trupore dhe të rënda trupore (20), dëmtim të pronës së huaj (14), grabitje (5), kërcënimin serioz (2), shkaktim të urrejtjes kombëtare, raciste ose fetare, përçarje ose intolerancë (6), shkaktim të rrezikut publik (2) dhe rrezikim të sigurisë (2). Shpesh ndodh që një incident të plotësojë kriteret për dy ose më shumë vepra të supozuara penale dhe për këtë arsye në të dhënat mund të ketë numër më të lartë të veprave penale sesa incidente të pranishme.¹³²

Llojet e incidenteve



Viktimat përballë autorëve

KMH vëren se viktimat dhe autorët janë kryesisht të rinj dhe pjesëtarë të prejardhjes së ndryshme etnike (maqedonase dhe shqiptare), anëtarë të grupeve të tifozëve sportivë ose mbështetës të partive politike, si dhe persona me statusin e refugjatit ose migrantit. KMH regjistron se pothuajse gjysma e incidenteve (46%) përfshinin të mitur, ose si viktimë (73 raste) ose si autorë (70 raste). Në më shumë se 60% të numrit të përgjithshëm të rasteve, është përfshirë më shumë se një autor, numri i saktë i autorëve nuk mund të deklarohet për shkak të mungesës së informacioneve nga autoritetet të publikuara për opinionin më të gjerë, ku ishin përfshirë disa autorë.




¹³²Krimet nga urrejtja përcaktohen nga Kodi Penal, ndërsa incidentet përfshijnë një gamë më të gjerë rastesh që përfshijnë veprat e tilla si grafite nga urrejtja, brohoritjet nacionaliste, etj.

Incidentet sipas lokalitetit

Të dhënat e KMH-së tregojnë se shumica e incidenteve – 118 – kanë ndodhur në Shkup dhe komunat përreth. Në Tetovë, ka pasur 10 incidente, 6 në Manastir, 5 në Gostivar dhe Ohër, 4 incidente në Kumanovë, 3 në Gjevgjeli dhe Prilep, 2 në Radovish dhe 1 incident në Koçanë, Strugë, Shtip dhe Strumicë. Ngjashëm me vitet e mëparshme, vazhdon rritja e numrit dhe përqindjes së incidenteve në kryeqytet.

Shumica e qyteteve gjenden në rajone në të cilat ka pakica të konsiderueshme etnike shqiptare (Shkup, Kumanovë, Kërçovë dhe Strugë), maqedonas etnikë (Tetovë dhe Gostivar), vllahë etnikë (Krushevë) ose disa pakica që së bashku përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të popullsisë (Manastir, Ohër, Strumicë dhe Koçanë). Dibra është një nga qytetet e rralla ku maqedonasit dhe shqiptarët jetojnë së bashku, e në vitin 2022 nuk u regjistruan raste të krimeve nga urrejtja.


Lokaliteti i incidenteve



Incidentet sipas muajit

Numri më i madh i incidenteve ka ndodhur në tetor (27) dhe shtator (19). Këto ishin muaj në të cilët KMH regjistroi rritje të dhunës midis të rinjve nga lagjet dhe shkollat e përziera etnike, sulme në linjat e autobusëve, stacionet e autobusëve dhe autobusët e përdorur nga anëtarët e bashkësive të ndryshme etnike. Ka pasur 16 incidente në gusht, 14 në shkurt dhe prill, 12 në maj, nëntor dhe dhjetor, 11 në korrik dhe qershor, 9 në janar dhe 3 në mars (numri më i ulët i incidenteve).

Incidentet sipas muajit



Ndihmë e siguruar juridike falas për viktimat e krimeve të urrejtjes në vitin 2022

Në vitin 2022, KMH ofroi ndihmë juridike falas në katër raste – tre nga incidentet ndodhën për shkak të orientimit seksual dhe/ose identitetit gjinor. Ndihma juridike falas përfshinte këshillimin juridik dhe sigurimin e informacioneve për mekanizmat juridikë për mbrojtjen e viktimave; komunikim me organet kompetente dhe shoqërimin e viktimave para institucioneve përkatëse; përpilim dhe parashtrim të kallëzimeve penale në Prokurorinë Publike dhe ndjekjen e procedurave gjyqësore në rastet e krimeve nga urrejtja. Një nga ato raste kishte të bënte me një sulm që ndodhi më 8 gusht të vitit 2022 në qendër të Strumicës, kur një aktivist LGBTI+ u sulmua fizikisht gjatë mbajtjes së një ngjarjeje publike me disa vullnetarë për të promovuar organizimin e tyre. Një burrë i moshuar ka filluar të kërcënojë dhe ofendojë verbalisht aktivistin, pas çka e ka sulmuar fizikisht, duke i shkaktuar lëndime trupore. Vullnetarët kanë braktisur vendin nga frika se edhe ata do të sulmoheshin. Komiteti i Helsinkit kontaktoi viktimën dhe i siguroi atij ndihmë juridike falas, pas çka KMH kërkoi nga SPB Strumicë të zbatojë hetim përkatës dhe të sanksionojë autorin, si dhe për të ndërmarrë të gjitha masat përkatëse duke marrë parasysh trajtimin policor të viktimës. Menjëherë pas kësaj, SPB Strumica parashtrori kallëzim penal, ndërsa aktakuza u ngrit Prokuroria Themelore Publike Strumicë. I pandehuri u deklarua fajtor, ndërsa Gjykata Themelore Strumicë më 28 nëntor të vitit 2022 e shpalli të pandehurin fajtor për lëndim trupor të ushtruar ndaj viktimës në bazë të krimit nga urrejtja. Gjykata konkludoi se duke sulmuar fizikisht dhe duke shkaktuar lëndime trupore ndaj aktivistit LGBTI në qendër të qytetit bazuar në orientimin seksual të viktimës, i pandehuri ka kryer veprë penale të "lëndimit trupor" sipas nenit 130 paragrafi (3) të Kodit Penal në raport me paragrafët (2) dhe (1) të nenit të njëjtë. Kështu, Gjykata e kualifikoi drejtë veprën e kryer penale si krim nga urrejtja sipas ligjit penal maqedonas, ndërsa gjatë shqiptimit të dënimit është marrë parasysh motivi i paragjykimit. I pandehuri u dënua me gjashtë muaj burg.

Në një rast tjetër, është ofruar ndihma juridike falas në maj të vitit 2022 një homoseksuali që e identifikon veten si kuir. Ai informoi KMH-në se më 26 qershor të vitit 2021, menjëherë pas "Shkup prajd 2021", në rr. "Miroslav Kërlezha" në Shkup, është sulmuar fizikisht nga tre të mitur. Ai e ka raportuar incidentin në stacionin më të afërt policor, ndërsa ka edhe raport përkatës mjekësor për lëndimet e marra trupore. Pothuajse një vit më vonë, më 5 maj të vitit 2022, ai u thirr në Prokurorinë Themelore Publike në Shkup për të bërë deklaratë si viktimë e ngjarjes që ndodhi më 26 qershor të vitit 2021. Një përfaqësues nga Komiteti i Helsinkit e shoqëroi atë në Prokurorinë Publike, por për shkak të natyrës private të hetimit, prokurori publik nuk lejoi që Komiteti i Helsinkit të jetë i pranishëm. Një përfaqësues nga Komiteti i Helsinkit ndoqi procedurat gjyqësore më 21 qershor të vitit 2022 në Gjykatën Themelore Penale Shkup, ku viktimë do të paraqitej si palë e dëmtuar, por gjykatësi na informoi se publiku ishte përjashtuar nga gjykimi sepse autorët ishin të mitur. Përfaqësuesi nga Komiteti i Helsinkit theksoi nenin 92 paragrafi 3 të Ligjit për drejtësi për fëmijët, duke përcaktuar se gjykata mund të lejojë praninë në gjykim të personave të tjerë të përfshirë në mbrojtjen dhe edukimin e fëmijëve, personave për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve me Avokatin e Popullit, personave të afërt me fëmijën, përfaqësuesve të organizatave për të drejtat e fëmijëve, si dhe shkencëtarëve. Gjykatësi propozoi që seanca të shtyhej deri në korrik të vitit 2022, me qëllim që Komiteti i Helsinkit të parashtrrojë arsyetim me shkrim të çështjes në gjykatë. Por, për shkak të faktit se ishte në interesin më të mirë të viktimës të përfundonte procedurën në të njëjtën ditë, përfaqësuesi i Komitetit u largua nga salla e gjykatës. Për shkak të faktit se viktimë ende nuk ka informata për veprën penale për të cilën akuzohen autorët, si dhe për shkak se do të jetë jashtë vendit duke kërkuar azil, Komiteti i Helsinkit ka kontaktuar një avokat i cili dëshiron të punojë përmes një autorizimi të posaçëm, që do të kërkojë procesverbalin e seancës së mbajtur më 21 qershor drejtpërdrejt nga Gjykata Themelore Penale. Deri më tani, avokati ka provuar në disa raste për të marrë procesverbalin, por Gjykata ende nuk ka dorëzuar procesverbalin e procedurës për të informuar palën nëse i është dhënë statusi i viktimës.

Në maj të vitit 2022, dy autorë sulmuan fizikisht dhe ngacmuan një aktivist LGBTI para nënës së tij, e sipas viktimës, incidenti ndodhi për shkak të orientimit të tij seksual. Në këtë incident, motivi i paragjykimit është orientimi seksual, me tregues të paragjykimit që ishin orientimi seksual – viktimë i përkiste një orientimi seksual dhe modeli të ndryshëm të incidenteve të mëparshme – incidente të

mëparshme kundër individëve të bashkësisë LGBTI, veçanërisht sulmet e mëparshme ndaj viktimës bazuar në orientimin e tij seksual. KMH iu drejtua viktimave, duke ofruar ndihmë juridike falas dhe mbrojtje në strehimore, por kjo u refuzua.

Komiteti i Helsinkit ndoqi një vepër penale në bazë të aftësisë së kufizuar të raportuar tek ekipi ynë juridik në vitin 2020. Një prind i një fëmije me autizëm raportoi në KMH se e gjithë familja ishte viktimë e abuzimit dhe kërcënimeve serioze nga dy fqinjët në ndërtesën në të cilën ata jetojnë, fqinjët vazhdonin të trokisnin në derën e familjes, duke bërtitur se do t'i vrisnin ata dhe fëmijën e tyre nëntëvjeçar me autizëm, të cilin ata e quanin “të retarduar mental”. Prejardhja e këtyre sulmeve është zhurma që dyshohet se është shkaktuar nga fëmija, familja ka raportuar rastin në stacion policie, por kjo ka përfunduar me një kallëzim policor, pas të cilit nuk është ndërmarrë asnjë veprim shtesë nga autoritetet për ngacmimet e pësuar nga familja dhe fëmija me aftësi të kufizuara intelektuale të shkaktuara nga fqinjët. Në vitin 2018, policia ka parashtruar kallëzim penal për “rrezikimin e sigurisë” sipas nenit 144 të Kodit Penal, të cilin Prokuroria Publike e ka refuzuar për shkak se ngjarja konkrete nuk ka përmbushur elementet e veprës penale që ndiqet sipas detyrës zyrtare, vepra penale e rrezikimit të sigurisë së fëmijës, bazuar në paaftësinë e tij intelektuale, e cila është e motivuar qartë nga intoleranca dhe paragjykimi tashmë ekzistues ndaj anëtarëve të këtij grupi të rrezikuar, mund të cilësohet si krim nga urrejtja, Prokuroria Publike ka refuzuar në mënyrë të padrejtë ankesën penale duke e cilësuar gabimisht veprën penale, duke marrë parasysh këtë, KMH do të parashtrojë kallëzim penal kundër autorëve për vepër penale të rrezikimit të sigurisë, si krim nga urrejtja, që sipas Kodit Penal ndiqet sipas detyrës zyrtare. Deri më tani, avokati dhe viktimat nuk janë të informuar për statusin e rastit, gjë që çon në konkluzionin se nuk është ngritur ende asnjë kallëzim penal.

3.2.4. Rekomandime

- Të sigurohet se gjykatat do të jenë të obliguara të evidentojnë arsyet edhe kur zbatojnë dispozita për rritjen e dënimit në rastet e krimeve të motivuara nga paragjykimi;
- Të sigurohet rritje specifike e dënimeve për krime të mëtejshme kundër pronës, të tilla si zjarrvënie, vjedhje, vjedhje e rëndë, grabitje, grabitje me armë ose vjedhje grabitëse;
- Të sigurohet një hetim dhe ndjekje e shpejtë dhe efikase e krimeve nga urrejtja duke siguruar që motivet e paragjykimit të merren parasysh gjatë procedurës penale;
- Të ndërmerren masat e duhura në mënyrë që të lehtësohen denoncimi i krimeve nga urrejtja, duke përfshirë edhe masat për të ndërtuar besimin në polici dhe institucionet tjera shtetërore;
- Të mbliidhen dhe publikohen të dhëna gjithëpërfshirëse dhe të krahasueshme për krimet nga urrejtja sa më shumë që të jetë e mundur, duke përfshirë numrin e incidenteve të tilla të denoncuar nga opinioni dhe të evidentuara nga organet për zbatimin e ligjit; numrin e dënimeve; motivet për paragjykim pas këtyre krimeve; dhe dënimet e shqiptuara;
- Vendosja dhe mirëmbajtja e bashkëpunimit midis autoriteteve publike dhe organizatave të shoqërisë civile për aspekte të ndryshme të punës me krimet nga urrejtja, siç janë trajnimi, mbështetja e viktimave dhe rritja e njoftimit;
- Ky bashkëpunim duhet të bazohet në shkëmbimin e të dhënave dhe informacioneve; të punojmë së bashku për të zbuluar aspektet e zymta të krimeve nga urrejtja; të bashkëpunojmë në zhvillimin e instruksioneve, udhëzimeve ose trajnimeve për evidentimin KU-ve, duke përfshirë shkëmbimin e ekspertizës për zhvillimin, përsosjen dhe revizionin e treguesve për paragjykim;
- Të sigurohet se viktimat e krimit nga urrejtja të mbështeten dhe mbrohen;
- Të përmirësohet komunikimi dhe koordinimi midis autoriteteve publike dhe institucioneve për çështjet që lidhen me krimet nga urrejtja;

-
- Të zbatohen hetime kombëtare për veprat penale që përfshijnë masat e krimit nga urrejtja si burim kryesor informacioni mbi përhapjen e krimeve nga urrejtja në vend;
 - Të promovohet trajnim për praktikuesit relevant që vijnë në kontakt me viktimat e një krimit nga urrejtja, duke u mundësuar atyre që t'i ndihmojnë në mënyrë efikase këto viktimat; dhe
 - Të përmirësohen masat parandaluese, ndër të tjera, duke reflektuar kujtimin në edukimin për të drejtat e njeriut, programet mësimore për histori dhe trajnime relevante, duke ndërmarrë hapa për edukimin e opinionit, veçanërisht të miturit dhe të rinjtë, për vlerat e diversitetit dhe përfshirjes kulturore, në mënyrë që të gjithë sektorët e shoqërisë të kenë rol në luftën kundër intolerancës së tillë.

Kapitulli 4 – LIRIA E SHPREHJES DHE BASHKIMIT

4.1. Liria e shprehjes

4.1.1. Standardet kryesore ndërkombëtare

Liria e shprehjes është e pandashme nga demokracia dhe bazohet në një numër¹⁶⁸ të madh instrumentesh kombëtare, evropiane¹⁶⁹ dhe ndërkombëtare që promovojnë këtë sistem politik, të njohur si i vetmi i aftë për të garantuar mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Maqedonia e Veriut ratifikoi të gjitha këto marrëveshje ndërkombëtare për lirinë e shprehjes. Me ratifikimin, ato u bënë pjesë integrale e rendit juridik të vendit.

Përmbajtja dhe fushëveprimi i mbrojtjes së lirisë së shprehjes janë zhvilluar kryesisht me jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (Gjykata). Gjykata, duke shpjeguar dhe interpretuar nenin 10 të *Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut*¹⁷⁰, vlerëson se *"liria e shprehjes përbën një nga bazat thelbësore të shoqërisë [demokratike], një nga kushtet themelore për përparimin e saj dhe për zhvillimin e çdo njeriu"*¹⁷¹. Gjykata ka theksuar në mënyrë të përsëritur se *"Neni 10 është i zbatueshëm jo vetëm për 'informacione' ose 'idetë' që priten pozitivisht ose konsiderohen si jo ofenduese ose sjellin indiferencë, por edhe për ato që ofendojnë, trondisin ose shqetësojnë; ato janë kushtet e pluralizmit, tolerancës dhe pikëpamjes së gjerë pa të cilat nuk ka 'shoqëri demokratike'."*¹⁷²

Siç është përcaktuar në nenin 10, liria e shprehjes u nënshtrohet përjashtimeve, të cilat duhet të arsyetohen në mënyrë rigorozë, ndërsa nevoja për çfarëdo kufizimesh duhet të përcaktohet në mënyrë bindëse.¹⁷³ Përveç këtyre mendimeve të përgjithshme, Gjykata në praktikën e saj gjyqësore i shqyrton edhe detyrimet pozitive të vendeve në mbrojtjen e realizimit të kësaj të drejte. Këto detyrime pozitive nënkuptojnë, mes tjerash, se nga vendet kërkohet të vendosin mekanizëm efikas për mbrojtjen e autorëve dhe gazetarëve me qëllim që të krijohet mjedis i favorshëm për pjesëmarrje në debat publik të të gjithë palëve të interesuara dhe t'u mundësohet atyre të shprehin mendimet dhe idetë e tyre pa

¹⁶⁸Shihni nenin 19 të Deklaratës universale për të Drejtat e Njeriut, në të cilin thuhet: "Gjithkush ka të drejtën e lirisë së mendimit dhe shprehjes; Kjo e drejtë përfshin lirinë për të pasur mendim dhe të pranohen dhe transmetohen informacione dhe ide pa ndërhyrje të autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky nen nuk i pengon vendet të kërkojnë licencim të ndërmarrjeve të radiodifuzionit, televizive ose ndërm ", elaboruar në mënyrë plotësuese në nenin 19 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike dhe në Komentin e përgjithshëm 10 [19] (neni 19) të Komitetit për të Drejtat e Njeriut (CCPR/C/21/Rev.1 të 19 majit v.1989).

Ova pravo ja vkluchuva slobodata da se ima misleње и da se primaat и пренесуваат информации и идеи без мешање на јавните власти и без оглед на границите. Овој член не ги спречува земјите да бараат лиценцирање на радиодифузни, телевизиски или кино претпријатија." Исто така, види член 11 од Повелбата за основните права на Европската Унија (2000 г.), кој гласи: „1. Секој има право на слобода на изразување. Ова право ја вклучува слободата да се има мислење и да се primaat и пренесуваат информации и идеи без мешање на јавните власти и без оглед на границите. 2. Ќе се почитуваат слободата и плурализмот на медиумите."

¹⁶⁹Shih, për shembull, nenin 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. "Gjithkush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë për të pasur mendim dhe për të marrë dhe dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrje nga autoritetet publike dhe pavarësisht nga kufijtë. Ky nen nuk i pengon vendet të kërkojnë licencimin e ndërmarrjeve radiodifuzive, televizive ose kinema". Shih gjithashtu nenin 11 të Kartës për të Drejtat Themelore të Bashkimit Evropian (v. 2000), në të cilin thuhet: "1. Secili ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë për të pasur mendim dhe për të marrë dhe dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrje nga autoritetet publike dhe pavarësisht nga kufijtë. 2. Do të respektohen liria dhe pluralizmi i mediave."

¹⁷⁰Për një rishikim gjithëpërfshirës të fushëveprimit të mbrojtjes sipas nenit 10 të KEDNJ-së, shih Biçavaska-Siniarska, E. (v. 2017). Mbrojtja e të drejtës së lirisë së shprehjes sipas Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Këshilli i Evropës.

¹⁷¹Hendisajd kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr. 5493/72. paragrafi. 49

¹⁷²Hendisajd kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr. 5493/72. Paragrafi 49; "Observer" dhe "Guardian" kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr. 13585/88. Paragrafi 59

¹⁷³Shtoll kundër Zvicrës, Nr. 69698/01, Paragrafi. 101; Moris kundër Francës, Nr. 29369/10, Paragrafi. 124; dhe Pentikenen kundër Finlandës Nr. 11882/10, Para. 87

frikë, madje edhe nëse ato bien në kundërshtim me ato të mbrojtura nga autoritetet zyrtare ose një pjesë e konsiderueshme e mendimit publik, ose nëse i irritojnë ose i trondisin këto të fundit.¹⁷⁴

Për më tepër, OSBE sërish i përforcoi dhe përcaktoi detyrimet specifike shtetërore në raport me mbrojtjen e lirisë së shprehjes. Ajo kërkonte që shteti të konfirmojë se secili do të kenë të drejtën e lirisë së shprehjes, duke përfshirë edhe të drejtën e komunikimit.¹⁷⁵ Me këtë rast, vendet janë të detyruara të paktën:

- të respektojnë të drejtën e secilit, individualisht ose në bashkëpunim me të tjerët, për të kërkuar, marrë dhe dhënë lirisht qëndrime dhe informacione për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, duke përfshirë edhe të drejtat për të përhapur dhe publikuar qëndrime dhe informacione të tilla;
- të respektojnë të drejtat e secilit, individualisht ose në bashkëpunim me të tjerët, për të studiuar dhe diskutuar respektimin e të drejtave të njeriut dhe liritë themelore dhe për të zhvilluar dhe diskutuar idetë për përmirësimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe mjeteve më të mira për të siguruar harmonizimin me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.¹⁷⁶

Këto parime themelore janë zhvilluar dhe operaqionalizuar në mënyrë plotësuese në shumë dokumente dhe deklarata të tjera të organizatës¹⁷⁷, duke përfshirë edhe vendosjen e standardeve dhe udhëzimeve specifike për sfidat e reja siç janë liria e shprehjes në internet¹⁷⁸, si dhe intelijenca artificiale¹⁷⁹.

4.1.2. Pasqyrë e zhvillimeve dhe sfidave kryesore

Informacione të përgjithshme

Kushtetuta merr një qasje liberale dhe të depërtueshme në garantimin e lirisë së shprehjes¹⁸⁰ duke vendosur disa masa mbrojtëse kushtetuese në realizimin e kësaj të¹⁸¹ drejte. Më tutje, duke njohur marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara si pjesë integrale të rendit të brendshëm juridik¹⁸² dhe si të zbatueshme drejtpërdrejt nga gjykatat¹⁸³, kjo ka hapur rrugën për integrimin e standardeve kryesore ndërkombëtare për të drejtat e njeriut (respektivisht për lirinë e shprehjes) si pjesë e kornizës normative në fuqi.

¹⁷⁴Dink kundër Turqisë, Nr. 2668/07, Parag. 137 Khadija Ismayilova kundër Azerbajxhanit, Nr. 65286/13, Para. 158

¹⁷⁵Shih Dokumentin e Takimit të Kopenhagenit të Konferencës mbi Dimensionin Njerëzor të KSBE-së, të 29 qershorit 1990, Kopenhagë. Seksioni 9.1 i Dokumentit thotë se: *gjithkush ka të drejtën e lirisë së shprehjes, përfshirë të drejtën për të komunikuar. Kjo e drejtë do të përfshijë lirinë për të pasur një mendim dhe për të marrë dhe dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrje nga autoritetet publike dhe pavarësisht nga kufijtë. Ushtrimi i kësaj të drejte mund t' u nënshtrohet vetëm atyre kufizimeve që parashikohen me ligj dhe që janë në përputhje me standardet ndërkombëtare. Në veçanti, nuk do të vendosen kufizime në qasjen dhe përdorimin e mjeteve të riprodhimit të dokumenteve të çdo lloji, duke respektuar, megjithatë, të drejtat që lidhen me pronësinë intelektuale, përfshirë të drejtën e autorit.*

¹⁷⁶Ibid. Seksioni 10.1 dhe 10.2.

¹⁷⁷Disa nga dokumentet e tjera kryesore brenda OSBE-së, përfshijnë: Vendimin nr. 193 Themelimi i Zyrës së Përfaqësuesit të OSBE-së për Lirinë e Medias, Mandati i Përfaqësuesit të OSBE-së për Lirinë e Medias (PC.DEC/193) dhe DEKLARATA E PËRBASHKËT e Raportuesit të Posaçëm të OKB-së për Lirinë e Opinionit dhe Shprehjes, Përfaqësuesit të OSBE-së për Lirinë e Medias dhe Raportuesit të Posaçëm të OAS-it për Lirinë e Shprehjes Një listë gjithëpërfshirëse e dokumenteve është në dispozicion të OSBE-së, ZOTOHET: Liria e Medias, Liria e Shprehjes, Rrjedha e Lirë e Informacionit 1975 – 2017, botimi i katërt.

¹⁷⁸OSBE. (2011). RAPORTONI lirinë e shprehjes në internet. Studimi i dispozitave dhe praktikave ligjore në lidhje me lirinë e shprehjes, rrjedhën e lirë të informacionit dhe pluralizmin e medias në internet në shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së

